

# 21 JANARI, MAZHORANCA I PERGJIGJET STRASBURGUT: BERISHA-BASHA, TE PANDEHUR



Arben Çuko: Ata janë urdhëruesit e vrasjeve, Ndrea Prendi zbatuesi. Flasim familjarët e viktimave. Berisha-Llalla kanë marrë peng 21 Janarin

NGA ADRIATIK DOÇI

# [SHQIPTARJA.com]

Lexoni  
Dëgjoni  
Shikoni  
EDICIONI MULTIMEDIAL



Kjo gazetë përdor teknologjinë QR-CODE

ÇMIMI 30 LEKË | VITI VI - NR. 86 | E MËRKURË, 13-04-2016 | www.shqiptarja.com

## RAPORTIMI NE KUVEND

### SHBA NIS PUNEN PER NJOHJEN E PENSIONEVE ME SHQIPERINE

Kreu i ISSH-së, Astrit Hado: Kemi filluar shkëmbimin e informacionit teknik

NGA **ESIONA KONOMI**

▶ F 8

## FUSHATA SENSIBILIZUESE



NË FOTO: Vajza e Ina Ballës

### INA BALLA, FRESSH I ÇON LEKET E MBLËDHURA DITEN E REFERENDUMIT

Nismës së Report TV për të ndihmuar nënën që vuan nga kanceri i gjirit, i janë bashkuar edhe të rinjtë e PS

▶ F 8



# Ish-ushtarakët

## JA KUR PERFITOHET FALJA E DEBIVE, SI BEHET RILLOGARITJA

### Ish-ushtarakëve debitë do t'u falen nga qershori. Ministria: Jo rillogaritje për pensionet

NGA **DRIÇIM ÇAKA**

▶ FAQE 9

**Vrasja mafioze e Beqirit, policia kap rojen e karburantit**

▶ F 13

**Trafikonte makina, gjykata liron këshilltarin Hasa**

▶ F 12

**Ndrea Prendi, pafajësi në gjykatë për të dytën herë**

▶ F 4

**LAJMI ORES SE VONE**

▶ F 4

**Shkodër, arrestohet polici me 10 kg drogë në makinë**

# Zabit Deda: Të administrohen dëshmitë e Sali Berishës

Mark Nika: Berisha dhe Llalla kanë marrë peng 21 Janarin

ADRIATIK DOÇI  
TIRANE

Familjarët e viktimave të 21 Janarit kanë një mesazh për Gjykatën e Strasburgut, e cila i kërkon informacion shtetit shqiptar për procedurat e gjyqimit të çështjes. Zabit Deda, vëllai i Hekuran Dedës, i vrarë në demonstratën e 21 Janarit, thekson se ka besim tek paanshmëria e Gjykatës së Strasburgut, ndërsa shton se hetimet duhet të nisnin me administrimin e dëshmitë të Sali Berishës. “Kemi besim të fortë tek Gjykata e Strasburgut. Unë kam ndjekur vetëm dy seanca, gjatë procesit të Agim Llluos. Nuk e kemi ndjekur procesin, pasi kërkonim lekë. Ne nuk kishim mundësi financiare. Procesi i zhvilluar në Shqipëri na ka vlarë për së dyti. Për ne, drejtësia duhet të nisë me dëshmitë e Sali Berishës. Berisha i ka ndryshuar disa herë dëshmitë, gjatë këtyre viteve”, ka theksuar Zabit Deda.



Zabit Deda

Mark Nika

“Ne i kemi humbur të gjitha shpresat tek gjyqësori shqiptar. I kemi humbur pasi për ne, ka pasur një koordinim mes prokurorisë, gjykatës dhe urdhëruesve të vrasjeve, për të mbyllur dosjen, pa u dënuar askush”.

Zabit Deda

“Nuk e kemi ndjekur procesin, pasi kërkonim lekë. Procesi i zhvilluar na ka vlarë për së dyti. Për ne, drejtësia duhet të nisë me dëshmitë të Sali Berishës. Berisha i ka ndryshuar disa herë dëshmitë”.



Premtimi

“Është premtuar që do të bëheshin të gjitha përpjekjet nga qeveria aktuale që të krijoheshin kushte ligjore, që drejtësia të vepronte si e pavarur, pasi ajo dihet që është e varur nga Berisha-Basha”

Përgjegjësia

Sipas Mark Nikës, shteti shqiptar nuk e ndjen përgjegjësinë për zbardhjen e ngjarjes së 21 Janarit. Ai thotë se pesë vite pas ngjarjes, ka një neglizhencë dhe heshtje të autoriteteve shtetërore.



Demonstrata e 21 Janarit 2011

ne familjarët është vdekjeprurëse. Qëndrimi i shteti të sotëm, që gjen alibi, për të justifikuar dështimin e drejtësisë në hetimin e këtij krimi të tmerrshëm, është i rëndë. Nuk akuzoj qeverinë aktuale, por jemi të zhgënjyer”, tha ai.

REFORMA NË DREJTËSI

Mark Nika thotë se nuk mund të ketë reformë në drejtësi me urdhëruesit e vrasjeve të 21 Janarit. Sipas tij, reforma në drejtësi është utopi. “Argumenti se nuk merret qeveria me hetimet, është alibi. Qeveria mori vota për të krijuar kushtet. Edhe reforma në drejtësi është utopi. Nuk mund të kryhet reforma në drejtësi me ata që kanë urdhëruar vrasjet në 21 Janar, pra me Sali Berishën dhe Lulzim Bashën”, thotë Mark Nika.

MARK NIKA

Mark Nika, xhaxhai i Aleks Nikës, i vrarë në 21 Janar dhe për të cilin prokuroria nuk ka identifikuar asnjë të dyshuar, mendon se mes prokurorisë, politikës dhe gjykatës ka pasur një bashkëpunim, për të mbyllur këtë çështje, pa dënuar asnjë njeri. “Siç dihet, ne i kemi humbur të gjitha shpresat tek gjyqësori shqiptar. I kemi humbur pasi për ne, ka pasur një koordinim mes prokurorisë, gjykatës dhe urdhëruesve të vrasjeve, për të mbyllur dosjen pa u dënuar askush.

DETAJET

Prokuroria ka lënë shtigje. Ka lënë mangësi. Ka vendosur prokurorë pa eksperiencë. Nuk kanë pranuar materialet tona të mbledhura privatisht. Prokuroria dhe Berisha kanë marrë peng çështjen. Shpresa e fundit është Gjykata e Strasburgut. Kemi besim tek

SHBA dhe BE. Kemi besim se i gjithë procesi i zhvilluar në Shqipëri do të hidhet poshtë një ditë”, ka deklaruar Mark Nika.

MESAZHI PËR QEVERINË

Mark Nika u shpreh i zhgënjyer për

qëndrimin e qeverisë aktuale. Ai tha se heshtja dhe alibia për 21 Janarin janë të papranueshme. “Ne pretendojmë se duhet të ishte bërë më shumë nga shumica e sotme. Jo vetëm nuk u krijuan kushte, por ka një heshtje të papranueshme. Një heshtje që për

Përgjegjësit  
TIRANE

## Idajet Beqiri: Kapobanda Berisha arkitekt i 21 Janarit

Ja pse Strasburgu ka të drejtë që të ndërhyjë për çështjen e 21 Janarit



MESAZHI

“Nëse ky kryekriminel nuk dënohet për këto 4 vrasje direkte, të cilat duhet t'i hapin më pas udhën ngritjes së akuzave të tjera të rënda nga krime kundër njerëzimit, deri te grabitja dhe shkatërrimi i pasurive kombëtare, tradhti e lartë kundër interesave të shenjta kombëtare, etj., ky popull do të mbeste peng i kriminalitetit”.

A vokat Idajet Beqiri mendon se Gjykata e Strasburgut ka të drejtë që të ndërhyjë për çështjen e 21 Janarit, ndonëse Gjykata e Lartë nuk e ka thënë ende fjalën e fundit. Beqiri thotë se Sali Berisha është arkitekti i këtij krimi, ndërsa e quan kapobandë. “Gjykata e Strasburgut po jep sinjalin e alarmit për të vepruar menjëherë, duke na siguruar se do të jetë në krah të shqiptarëve në luftën kundër krimit të organizuar shtetëror dhe kapobandës Berisha që e udhëheq dhe frymëzon këtë krim. Kjo Gjykatë është në të drejtën e saj ta bëjë këtë gjë, sepse pas vendimit skandaloz të Gjykatës së Apelit, vendimi quhet i formës së prerë. Gjykata e lartë u bë një hallkë trutharë për rastin konkret. Ajo e trajtoi këtë krim shtetëror, njëllëj si një krim banal ordiner! Ndaj Strasburgu e ka të drejtën me pash të ndërhyjë dhe ta kon-

stattoj procesin e pa rregull ligjor ndaj këtij krimi barbar”, thotë ai. Sipas avokatit,

dy janë përgjegjësit për këtë ngjarje. “21 janari është krimi më i rëndë shtetëror i dyshes

kriminale Berisha-Basha. Një krim që u bë në mesin e ditës. Një vrasje makabër që ju bë katër qytetarëve të pafajshëm të Shqipërisë nga kryebanditi Berisha, në funksionin e ish kryeministrit të vendit, si dhe nga “konja” e tij ndërsyerëse Basha, ish ministër i Brendshëm. Këta të dy ishin organizatorët, ideatorët, frymëzuesit dhe urdhëruesit e 4 vrasjeve”, thekson Beqiri. Sipas tij, vrasjet ishin jo vetëm me paramendim, për motive të dobëta, por edhe të mirëmenduar kohë më parë, që në momentin që u deklarua



Idajet Beqiri

nga opozita data e protestës para Kryeministrit. Beqiri shton se Berisha dhe Basha vendosën për të vlarë protestuesit pasi protesta ishte shpërndarë dhe njerëzit po iknin. “Aq e vërtetë është kjo, sa kjo dyshe kriminale Berisha-Basha, kur panë se protesta po mbyllej dhe para Kryeministrit kishin mbetur shumë pak protestues, pasi shumica

ishite larguar, “për të mos u ikur zogu nga dora” dhanë menjëherë urdhrin famëkeq dhe e përgjakën Bulevardin Dëshmorët e Kombit. Kryebanditi Berisha u hakmor me egërsi sepse selinë e Kryeministrit e konsideroi si kullën e tij në Viçido! Dhe kështu tregoi se është një gjakpirës e vrasës po aq irrezikshëm sa Millosheviçi, sa Arkani, sa Hitleri mizor.



# 4 PYETJET

A kanë kryer autoritetet një hetim efektiv për vdekjen e të afërmeve të ankuësve?

A u kanë shteruar aplikantëve të gjitha mjetet efektive të brendshme?

A ka pasur shkelje të të drejtave të ankuësve?

A ka pasur shkelje të së ankuësve, për akses në gjykatë?

# Mazhoranca-Strasburgut: Berisha e Basha, të pandehur

## Arben Çuko: Berisha dhe Basha urdhëruesit e vrasjeve të 21 Janarit, Ndrea Prendi zbatuesi

ADRIATIK DOÇI  
TIRANE

**M**azhoranca qeverisë nuk ka dilema sa i takon përgjegjësinë për katër pyetjet e Gjykatës së Strasburgut, për dosjen e 21 Janarit. Një ditë pas dokumentit të publikuar nga Shqiptarja.com, përfaqësues të shumicës në pushtet, kanë një përgjigje

për Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila ka marrë në shqyrtim kërkesën e familjarëve të viktimave për mohimin e aksesit në proces dhe shkeljen e procedurave të gjyqimit. Ish-komandanti i Gardës së Republikës, aktualisht anëtar i Komisionit të Sigurisë, Arben Çuko thotë se drejtësia për 21 Janarin nis me hetimin e Sali Berishës dhe Lulzim Bashës, duke i identifikuar si përgjegjësit kryesorë për vrasjen e katër protestuesve, plagosjen e gjashtë të tjerëve, manip-

ulimin e pronave, zhdukjen e pamjeve filmike etj. "Ne si mazhorancë kemi një përgjigje. Duhet të merren të pandehur Sali Berisha dhe Lulzim Basha. Ndrea Prendi është thjeshtë ekzekutor i urdhrave të lëshuar nga kryeministri dhe ministri i Brendshëm i asaj kohe. Ka një linjë komandimi, që nis me kryeministrin, ministrin e Brendshëm dhe komandantin e Gardës. Kemi besim tek Gjykata e Strasburgut. Gjykata shqiptare i provuam. Rezultati është ky që është", u shpreh

Arben Çuko. Deputeti socialist shtoi se kjo shumicë nuk do të heqë dorë kurrë nga zbardhja e 21 Janarit dhe ndëshkimi i orkestruesve të kësaj ngjarjeje.

### KUSHTI PËR DREJTËSINË

Ish-ministri i Brendshëm, sot zëvendësministër i Mbrojtjes, Petro Koçi, ka theksuar se vënia para përgjegjësisë dhe vrasësve dhe urdhëruesve të vrasjeve të 21 Janarit është një mundësi për të besuar në sistemin e drejtësisë. Sipas tij, tashmë ka ardhur koha që Sali Berisha dhe Lulzim Basha të përgjigjen para ligjit, për vrasjen e 21 Janarit. "Vënia para përgjegjësisë dhe vrasësve dhe urdhëruesve të krimin të 21 Janarit është një shans për të besuar te drejtësia, qoftë kjo e ardhur edhe nga Strasburgu. Nga ana tjetër, kjo do të na ndihmonte si shoqëri për të ndërtuar shtet, një shtet ku çdo nëpunës apo politikan vepron sipas ligjeve dhe jo sipas orekeseve partiake. Ka ardhur koha që Berisha dhe Basha të përgjigjen para ligjit. E bashkë me ta edhe kushdo që para ligjit të urdhrin e Saliut", ka deklaruar Petro Koçi, kryetar i PSV '91.

Arben Çuko. Deputeti socialist shtoi se kjo shumicë nuk do të heqë dorë kurrë nga zbardhja e 21 Janarit dhe ndëshkimi i orkestruesve të kësaj ngjarjeje.

### FSHIRJA E PAMJEVE

Ish-ministri i Brendshëm, Petro Koçi thekson se fshirja e pamjeve filmike është akti më i fëlliqur pas kësaj ngjarjeje. "Nëse nuk vendoset drejtësi për krimet e kryera publikisht merreni me mend se ku propozen krimet e kryera në fshehtësi. Fshirja e provave të zhvillimeve brenda kryeministrisë në 21 Janar nëpërmjet fshirjes së serverit të kamerave është ndofta akti më i fëlliqur në gjithë ngjarjet e rënda të asaj dite të zezë. Uroj që Strasburgu të vendosë me rreptësinë e së drejtës", ka theksuar Koçi.

### KOMANDIMI

"Ndrea Prendi është thjeshtë ekzekutor i urdhrave të lëshuar nga kryeministri dhe ministri i Brendshëm i asaj kohe. Ka një linjë komandimi, që nis me kryeministrin, ministrin e Brendshëm dhe komandantin e Gardës".

### PROVAT

"Fshirja e provave të zhvillimeve brenda kryeministrisë në 21 Janar nëpërmjet fshirjes së serverit të kamerave është ndofta akti më i fëlliqur në gjithë ngjarjet e rënda të asaj dite të zezë".



Arben Çuko

## Qëndrimi

### Plani i PS për 21 Janarin, PD i qëndron puçit

Për mazhorancën qeverisë, procesi gjyqësor për 21 Janarin dhe Gërdecin, nuk ka nisur ende. Edhe pse drejtësia shqiptare tashmë po lan duart gradualisht me dosjen e 21 Janarit, shumica në pushtet, mendon se do të ketë një hetim dhe gjykim nga zero për këtë çështje. Në kampin e shumicës në pushtet qarkullon gjithashtu edhe një tezë, sipas të cilës, dosja e 21 Janarit, edhe pse ende nuk e ka thënë fjalën e saj Gjykata e Lartë, do të hapet pas finalizimit të reformës në drejtësi. Mazhoranca ka kontestuar të gjitha vendimet e deritanishme të gjykatave për çështjen e 21 Janarit. Nga ana tjetër, për opozitën shqiptare, asokohe në pushtet, kjo çështje është e mbyllur. Opozita e sotme vijon t'i qëndrojë versionit të puçit të shtetit. Po ashtu, Partia Demokratike pretendon se Grada e Republikës ka vepruar brenda rregullores dhe ligjeve. Teksa palët ndajnë qëndrime të kundërta, BE-SHBA vijojnë të ushtrjnë presion për zbardhjen e ngjarjes.

## REKURSI / KOLEGJI PENAL ENDE NË DILEMË

# 21 Janari, Gjykata e Lartë thyen çdo rekord zvarritje

Gjykata e Lartë po thyen çdo rekord sa i takon bllokimit të shqyrtimit të rekursit të Prokurorisë së Apelit, për çështjen e 21 Janarit. Shkalla më e lartë e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë po jep një mesazh negativ edhe për shkallët më të ulëta të gjyqësorit, sa i takon çështjes ndaj çështjes më të nxehtë dhe sensitive të viteve të fundit. Çfarë po ndodh? Në tetor të vitit 2013, Prokuroria e Apelit dorëzoi një rekurs për çështjen e 21 Janarit. Po kalon vitit i tretë dhe Dhoma e Këshillimit nuk ka vendosur ende nëse rekursi i Prokurorisë do të kalojë apo jo në gjyq.

Zyra e shtypit e Gjykatës së Lartë pati deklaruar se, në ditët e para të muajt shkurt, Dhoma e Këshillimit do të merrte një vendim për fatin e rekursit të Gjykatës së Lartë.

### Procedura

Kur kolegji vendos se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuar nga ligji, vendosë mospranimin e rekursit dhe dosja gjyqësore, i dorëzohet sekretarisë

Megjithatë, në Gjykatën e Lartë ende nuk ka asnjë lëvizje për këtë çështje. Ka një pretendim se arsyeja e zvarritjes ka të bëjë me volumin e dosjes, por ka dyshime të forta se arsyeja kryesore lidhet me pafuqinë e kësaj gjykate për të marrë në dorë dosjen e 21 Janarit, për shkak të personave të veshur me pushtet, të cilët preken nga kjo çështje. Si rregull, dosja gjyqësore shqyrtohet në Dhomën e Këshillimit, me pesë gjyqtarë, e cila vendos nëse rekursi i paraqitur ka apo shkaqe ligjore nga ato të parashikuara nga ligji. Në rastin kur Kolegji përkatës vendos se ka shkaqe ligjore, çështja kalon për gjyq.



### Presioni

Çdo vendim mbi rekursin e Prokurorisë, do ta vendosje Gjykatën e Lartë para një presioni të papërballeshëm politik.

Por, Çdo vendim për rekursin e Prokurorisë, do ta vendoste Gjykatën e Lartë, para një presioni të papërballeshëm. Në këto kushte, gjykata ka zgjedhur një rrugë të ndërmjetme, duke mos u shprehur mbi rekursin.

# Ndrea Prendi fiton pafajësi në gjykatë për të dytën herë

## Gjykata shpall pa faj dhe ish-zv/komandantin Artan Hoxha. Dënohet vetëm financierja online

ELTON QYNO  
TIRANË

**N**drea Prendi, që nuk bëri asnjë ditë burg për vrasjen e Faik Myrtajt në protestën e opozitës të 21 janarit 2011, është deklaruar sërish të pafajshëm nga gjykata e Tiranës, për akuzën e "Shpërdorimit të detyrës" dhe "Falsifikim dokumentash". Vendimi për pafajësinë e Prendit është dhënë pak kohë më parë, ndërkohë që pafajësi ka marrë dhe ish-vartësi i Prendit, Artan Hoxha, i cili ka qënë zv/komandant i Gardës së Republikës. Ndërkohë një dënim me dy vite në shërbim prove, gjykata e Tiranës e ka dhënë për të pandehurën tjetër Shqipe Jasimi (Spahiu), me detyrë ish-financiare në Gardë, e cila ka qënë në marrëdhënie pune dhe ka marrë rrugën edhe gjatë kohës, ku ajo është larguar jashtë shtetit. Gjykata e Tiranës nuk mori në konsideratë provat e prokurorisë së Tiranës kundër tre të pandehurve, me argumentin se shkellet e bëra nga ish-zyrtarët e Gardës së Republikës nuk kanë sjellë asnjë dëm financiar. Në pretendencën e saj prokuroria kërkoi që Ndrea Prendi të dënohet me një vit burg, por sipas gjykatës ish-gardisti nuk ka shpërdoruar detyrën dhe për pasojë është shpallur i pafajshëm. Në dosjen hetimore thuhet se këta tre ish-funksionarë të Gardës së Republikës u hetuan për akuzën e shpërdorimit të detyrës e falsifikim dokumentash pasi duke paguar Shqipe Jasimin pa qenë e pranimshme në punë i kishin shkaktuar shtetit një dëm ekonomik në vlerën e 616.000 lekë.

### 7 MUAJ PUNË

Prendi dhe Hoxha për 7 muaj me rradhë i kanë dhënë rrogë Shqipe Spahiu, kur kjo e fundit nuk ka qënë asnjë ditë në punë. Sipas prokurorisë, në përfundim të hetimeve, është provuar



Artan Hoxha



Ndrea Prendi

### Puna Online

Shefa e personelit është shprehur se për arsye familjare nuk mund të kthehet në Shqipëri, por është e gatshme të kontribuoj duke punuar online me stafin me të njëjtin përkushtim, sikur të ishte në detyrë, gjatë gjithë kohës fizikisht.

se dy ish-drejtesit e Gardës kanë abuzuar me ligjin, duke firmosur për tre vjet nga 2011-ta deri me 2013-en pagën për ish shefen e sektorit të buri-meve njerëzore Shqipe Spahiu, e cila për 7 muaj nuk i ka ngjitur shkallët e institucionit. Kjo është provuar nga verifikimi i dhënave të sistemit TIMS,

ku ish-shefja e personelit Shqipe Spahiu ka rezultuar jashtë Shqipërisë.

### IKJA DHE RIKTHIMI

Është miratuar, largimin e Shefes se Personelit në fund të vitit 2009, për të shkruar jashtë shtetit, pasi atje ndodhej i shoqi dhe dy fëmijet e saj, duke përfshirë lejen vjetore për këtë vit, por duke pasur parasysh që ekzekutimi i kërkesës për largimin nga puna do të behet me fillimin e vitit 2010, me qëllim që të mbylleshin problemet e fundit të vitit me personelin. Me largimin e shefes së personelit, puna në sektorin e personelit nuk po funksiononte siç duhej. Specialista e personelit e sapo emëruar, me gjithë përpjekjet e shumta që bënte, nuk po arrinte në nivelin e duhur dhe në fillim të vitit 2010 kërkoi të largohej, pasi nuk e përballonte dot detyrën që kishte marrë. Për specialistin e organizimit, për shkak të specifikës së punës me ushtaret dhe

arsyeve personale shëndetësore, ishte e pamundur angazhimi me detyrat e Personelit. Në këtë situatë kur puna në sektorin e personelit u bllokua, i është kërkuar shefes së personelit të shikoj mundësinë e rishikimit të kërkesës për largim nga Garda edhe për disa muaj, pasi gjatë kësaj periudhe fillonte puna përgatitore për procesin e konkurimit për gradë të efektivit dhe më e rëndësishmja duhej të realizohej zëvendësimi i ushtarëve aktiv me nënoficer profesionist me pagesë, një punë mjaft e madhe dhe që duhej të realizohej në një kohë të shkurtër, pasi rrezikohesh përmbytja e detyrës me lirim e ushtarëve të gjithë njëherësh. Shefa e personelit ishte pjesë e grupit të punës prej dy vitesh në diskutime të shumta me drejtuesit e strukturave në Gardë, strukturat e linjës në Ministrinë e Brendshme dhe në Ministrinë e Financave, dhe njihje mire të gjithë procedurën e nevojshme për këtë qëllim.

### Dy pafajësi

Vendimi për pafajësinë e Prendit është dhënë nga gjykata e Tiranës, pak kohë më parë ndërkohë që pafajësi ka marrë dhe ish-vartësi i Prendit, Artan Hoxha, i cili ka qënë zv/komandant i Gardës së Republikës.

### LAJMI I ORES SE VONE

**Shkodër, arrestohet polici me 10 kg drogë në makinë**

Nënoficeri i policisë Zef Mirashi është arrestuar dje në Shkodër me 10 kilogramë drogë në makinë. Operacioni është zhvilluar dje në orët e vona të mbrëmjes nga SHKB dhe Anti-Droga. Sipas informacioneve të para Mirashi kishte disa muaj që ishte në hetim nga SHKB dhe Anti-droga të cilat dje kanë finalizuar aksionin. Veç arrestimit të efektivit të policisë janë shpallur në kërkim edhe dy bashkëpunëtorë të tij. Zef Mirashi ishte me detyrë shef i stacionit të policisë në Theth. Ai kishte 15 vite që mbante veshur uniformën e policisë dhe kishte gradën nënoficer. Lënda narkotike e tipit cannabis sativa u gjet në bagazhin e makinës. Sipas informacioneve të para dyshohet se kjo lëndë narkotike do të shpërndahet në qytetin e Shkodrës.

### PRANGOSJA

**I dënuar për trafik droge arrestohet në Rinas 23-vjeçari**



Një 23-vjeçar nga Kavaja është prangosur në aeroportin e Rinasit, pasi gjatë përpunimit të dokumentacionit rezultoi se është dënuar me 4.8 vite burg për trafik të drogës. Sipas policisë, gjatë përpunimit të dokumentacionit të shtetaseve të kthyer deportiv, rezultoi se Sulejman Vogli, 23 vjeç, pasi ishte i shpallur në kërkim, duke qenë se ishte i dënuar me 4 vjet e 8 muaj burg për veprën penale "Prodhim e shitje e lëndëve narkotike". 23-vjeçari i'u dorëzua për shoqërim e procedura të mëtejshme patrullës së policisë së Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan.

## MINISTRI MANJANI I PEZULLON VEPRIMPTARINË MARTIN TUSHES

# U arrestua për vjedhjen e 9 milionë lekëve, pezullohet përmbaruesi

Ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani ka urdhëruar pezullimin e certifikatës së ushtrimit të veprimtarisë përmbarimore të përmbaruesit gjyqësor Privat Martin Tusha, i cili u arrestua dje për akuzën e "vjedhjes duke shpërdoruar detyrën". Ndaj Tushës, Gjykata e Tiranës ka pran-

uar kërkesën e prokurorisë duke vendosur për caktimin e masës së sigurisë "arrest në burg", në mungesë. Nisur nga kjo, Manjani urdhëroi pezullimin e certifikatës së ushtrimit të veprimtarisë përmbarimore Nr 44, datë 10/09/2010 të përmbaruesit gjyqësor privat Martin Tusha, për aq kohë sa janë në fuqi

veprimet hetimore të procedimit penal në ngarkim të tij. Duke marrë shkas nga ky rast, ministri tërheq vëmendjen ndaj të gjithë shërbimit përmbarimor privat që të jenë korrekt në ushtrimin e funksionit të tyre, veçanërisht në rastet e titujve ekzekutiv, duke përdorur llogari të posaçme për zbatimin e tyre. Martin



Tusha u arrestua një ditë më parë nga policia e Tiranës me kërkesë të Prokurorisë, pasi

dyshohet se i ka vjedhur 9 milionë lekë ish-klientit të tij me iniciale S.M.

# Ushtarakë e një prokuror do ndjekin ekspertizën në Gjermani

## Kompania "Eurocopter" pezullon prodhimin e helikopterit EC-145. Pezull dhe në Shqipëri

Një grup ekspertësh Franko-Gjermanë dhe Shqiptarë, ku do asistojë dhe një prokuror nga Shkodra, do qëyrin pamjet filmike të kameras të helikopterit dhe zërin audio të polotëve që ka rregjistruar kjo pajisje elektronike. Kamera dhe kutia e zezë, do përcillet nëpërmjet një letërporosie në Gjermani, ku prokuroria e Shkodrës është duke ndjekur të gjithë procedurën standarde. Vendimi për t'u ekspertuar në Gjermani, vjen në një kohë kur policia shkenore në Shqipëri nuk kishte mundësitë teknike për të bërë hapjen e këtyre pamjeve filmike, për të mësuar se çfarë ka ndodhur me helikopterin ushtarak EC-145. Burimet thanë se hapja dhe rikuperimi i pamjeve me figurë dhe zë, do të bëhet nga një komision, me anëtarë të kompanisë së prodhimit të helikoptereve, përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes e Shtabit të Përgjithshëm si dhe në prani të një prokuror që do të dërgohet nga Shqipëria. Ky komision, thonë burimet do të asistojë në momentin që ekspertët e kompanisë franko-gjermano do të bëjnë hapjen dhe rikuperimin e pamjeve të regjistruara nga kamera.

### SKEMË 3D E DINAMIKËS SË NGJARJES

Mësohet se kompania, është zotuar se krahas rikuperimit të zërit dhe figurës së filmuar, do të paraqesë në 3D të gjithë lëvizjet e helikopterit dhe manovrat që pilotët kanë kryer që nga momentin i nisjes deri në rrëzimin e tij në liqenin e Shkodrës. Ky

ekzaminim, burimet thonë se do të bëhet shumë shpejt, por duke mos përcaktuar kohën. Por është vet kompania, thonë burimet, që këmbëngul që ky ekzaminim të kryehet sa më shpejt, për shkak se është pezulluar

prodhimi i këtyre helikoptereve EC-145.

### PEZULLOHET PRODHIMI I "EC-145"

Përveç pezullimit, mësohet se kompania franko-gjermane ka dërguar shkresa zyrtare në

të gjithë vendet e botës, që kanë në përdorim helikopter të tillë, mes tyre edhe Shqipërisë që të pezullojnë fluturimet me këtë lloj helikopteri deri sa të zbardhet shkaku i rrëzimit të tij në Shqipëri. Nga ana tjetër, burimet thonë se prokuroria,

përveç sekuestrimit të gjithë praktikës së ndjekur nga regjimenti i helikoptereve në Farkë, për fluturimin e EC 145 me dy pilotët në bord, ka sekuestruar edhe komunikimet me radio të pilotëve me Kullën e Trafikut në Farkë gjatë ditës së ngjarjes.

Si dhe kanë marrë në pyetje personelin ushtarak që ka komunikuar ditën e ngjarjes me dy pilotët, personat që kanë miratuar planin e fluturimit si dhe komandantin e regjimentit të Helikoptereve në Farkë.



Helikopteri i aksidentuar duke u nxjerrë nga liqeni

**PROPOZIMI**



**Kodheli-Nishanit: Dy pilotëve tu jepet "Dekorata e Artë e Shqiponjës"**

Për dy pilotët Florian Deliu dhe Donald Hoxha që humbën jetën nga rrëzimi i helikopterit Ministria e Mbrojtjes vendosi ti shpallë ata dëshmorë të atdheut. Ministria e Mbrojtjes Mimi Kodheli i ka propozuar sot Presidentit të Republikës, dhënie e "Dekoratës së artë të Shqiponjës" (pas vdekjes), për dy pilotët e Forcave të Armatosura, Florian Delia dhe Donald Hoxha. Në kërkesën e ministres Kodheli thuhet se dekorimi i kapiten Florian Delia dhe toger Donald Hoxha bëhet me motivacionin: "Për veprimtari ose akte të guximit qytetar në kohë paqjeje". Propozimi i ministres Kodheli vjen pas vendimit të marrë nga Komisioni Qendror i Statusit "Dëshmorët e Atdheut" për t'i shpallur dy pilotët, "Dëshmorë të Atdheut". Në propozimin dërguar presidentit të Republikës thuhet gjithashtu se kapiten Florian Jahja Delia dhe toger Donald Vesel Hoxha, kanë qenë ushtarakë të devotshëm, pilotë të talentuar dhe gjithmonë të gatshëm të sakrifikonë për të tjerët. Dy pilotët humbën jetën 6 ditë më parë, pas rrëzimit të helikopterit të Ushtresë EC 145, në ujërat e Liqenit të Shkodrës.

# Rrëzimi i helikopterit, Llalla takim informues me presidentin

## Kryeprokurori informon kreun e ushtresë Bujar Nishanin

Një javë nga rrëzimi i helikopterit të forcave ushtarake në liqenin e Shkodrës, kryeprokurori Adriatik Llalla informon presidentin e Republikës Bujar Nishani në lidhje me ecurinë e hetimeve për të zbardhur shkaku që shkaktoi rrëzimin e mjetit fluturues. "Report Tv" ka mësuar se takimi i djeshëm që zgjati për 35 minuta në ambjentet e presidencës, është kërkuar nga Nishani në cilësinë e Komandantit të Forcave të Armatosura. Por cilat janë pistat e hetimit të ngritura nga prokuroria? Pas nxjerrjes së helikopterit nga ujërat e liqenit të Shkodrës, hetimet janë fokusuar në dy pista, ajo e një gabimi njerëzor dhe defekti teknik. Dyshimet e një defekti teknik janë shtuar pas një aksidenti të ndodhur 4 vite më parë me një helikopter po të



Adriatik Llalla dhe Bujar Nishani

ushtresë shqiptare me të njëjtin prodhues, kompaninë eurocopter, ku 6 pjestarët e stafit të saj po kolaudonin Airbus Cougar në aplet e Francës një ditë

para se ta sillnin në Shqipëri. Për këtë shkak, pala shqiptare ka kërkuar rezultatet e hetimit të nxjerra nga pala franceze në aksidentin e ndodhur në

alpet e Francës më 25 Qershor 2012. Një tjetër kërkesë për autoritetet franceze është bërë dhe për mundësinë e sjelljes së ekspertëve për të rikuperuar pamjet filmike të kameras së bordit të Airbus EC-145, të gjetur në ujërat e liqenit, pasi me mundësitë teknike që disponon Shqipëria s'mund të hapen. Ndalur tek gabimi njerëzor, burimet thanë për "Report Tv" se shkak mund të jetë bërë devijimi i planit të fluturimit dhe lartësia e ulët e përdorur në fluturim ç'ka ka pamundësuar një manovër për ulje emergjente të helikopterit pasi ai është anuar dhe helika ka prekur në ujë. Në rrëzimin e helikopterit më 6 Prill në liqen, humbën jetën 2 ushtarakë, Florian Deliaj dhe Donald Hoxha, të shpallur Dëshmorë të Atdheut, ndërsa togeri Gerald Baramuçka mbeti i plagosur.

**STUDIO PËRMBARIMORE "SPEED SOLUTION" sh.p.k NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT 2 PËR:**

Arë me sipërfaqe 4000 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Nr.1247, Nr.Pasurise 214/16, Vol.5, Faqe.212 me vendndodhje Borizanë Krujë, me vlerë **338 240 ( treqind e tridhjetë e tetë mijë e dyqind e dyzet) Lekë**, hipotekuar në emër të FAF sha.

Pemtores me sipërfaqe 5890 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Nr.1475, Nr.Pasurise 270/11, Vol.4, Faqe.245 me vendndodhje Derven Krujë, me vlerë **1 187 424 ( një milion e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e njëzet e katër) Lekë**, hipotekuar në emër të FAF sha.

Ankandi do të zhvillohet më datë **05.05.2016, Ora 16:00**, pranë Studios Përmbarimore "SPEED SOLUTION" sh.p.k me Adresë: Bulevardi "Gjergj FISHTA" Kulla. 1, Kati. 2, Nr.3, Tiranë.

**Për çdo informacion mund të kontaktoni**  
cel.0693041355; 0696334695; e-mail: speed.solution@yahoo.com

# PS-LSI nuk gjejnë paqe për sektorin e bujqësisë

Petrit Vasili letër Edi Ramës: Të ndërhyhet, Maqedonia po na bllokoi prodhimet tona

ESIONA KONOMI  
TIRANË


Muaji prill ka nisur me një debat mes dy partive qeverisëse, PS dhe LSI lidhur me sektorin e bujqësisë. I pari që e ka nisur këtë debat, ishte kreu i komisionit të ekonomisë, Erjon Braçe i cili akuzoi Ministrin e Bujqësisë të drejtuar nga LSI si të paafte dhe shkaktoar të disa problemeve të rëndësishme të fermerëve në Lushnjë. Një ditë më pas, Petrit Vasili ju drejtua me një letër kryeministrit Rama ku i kërkonte ndërhyrje emergjente në sektorin bujqësisë, dhe i sugjeronte disa ndryshime në praktikën doganore të prodhimeve bujqësore. Por ankesat e Braçes u shtuan ditën e hënë, kur në mbledhjen e grupit parlamentar, ai paralajmëroi humbjen e miliona dollarëve në ekonominë shqiptare si pasojë e dëmeve që po pësojnë fermerët e Myzeqesë. Edhe në këtë rast, një ditë më pas, kreu i grupit të Lëvizjes Socialiste për Integrit Petrit Vasili i është drejtuar me një letër të dytë kryeministrit Edi Rama dhe ministrit të Financave, Arben Ahmetaj mbi problemet në sektorin e bujqësisë. Ndryshe nga Braçe që e sheh problemin tek efikasiteti i Ministrisë së Bujqësisë, Vasili e sheh problemin tjetër kund, pikërisht tek sistemi doganor i drejtuar nga një ministër socialist. Madje në hyrje të letrës së tij, Vasili thekson se nuk ka pasur asnjë ndërhyrje dhe reagim pas letrës së tij të parë, duke e quajtur këtë fakt, një veprim jo korrekt politikisht dhe etikisht. "Më 31 mars 2016 ju kam drejtuar një letër ku specifikoj këto shqetësime dhe jam i keqardhur që nuk pata asnjë përgjigje apo veprim konkret, e besoj se kjo është politikisht dhe etikisht jokorrekte".



shkruan Vasili. Vërejtjeve të letrës së mëparshme, Vasili i ka shtuar edhe një shqetësim lidhur me doganat maqedonase.

Në letrën drejtuar Kreut të Qeverisë dhe ministrit të Financave kërkohet që të merren masa lidhur me qëndrimin e një anshëm e penalizues të doganës maqedonase ndaj prodhimeve bujqësore shqiptare. Sipas Vasilit, ministria e Financave duhet të ndërhyjë dhe të pengojë këtë praktikë negative për fermerët shqiptarë duke rrezikuar që të thellohet edhe më shumë në muajt në vijim kur pritet një rritje e prodhimeve bujqësore në vend. Vasili propozon ndërhyrjen me akt normativ të Qeverisë për të lejuar kryerjen e shit-blejeve me para në dorë deri në 100 mijë lekë për fermerët

në pikat e grumbullimit dhe agro-përpunimit. Sipas tij ka një vakuum ligjor në këtë pikë që duhet të korrigjohet me urgjencë. "Pjesa më e madhe e fermerëve nuk zotërojnë konto bankare dhe janë larg shërbimeve bankare, duke e parë veten padrejtësisht të përjashtuar nga e drejta e shitjes së prodhimeve. Kërkohet zgjidhje urgjente, sepse po afrohet piku i prodhimit dhe pengesat në shitje do të çojnë në kalbje dhe dëmtime të prodhimeve në sera dhe arë dhe humbje të mëdha për fermerët. Ju propozojmë të vlerësohet nga ju që ky problem të rregullohet me akt normativ, e drejta për të



Shqetësimet

## Maqedonasit

"Qëndrimi i njëanshëm e penalizues i doganave maqedonase, ka krijuar tonelata të tëra prodhimesh të kalbura, që dalin jashtë prodhimit duke dëmtuar rëndë fermerët dhe grumbulluesit e produkteve".

## Bankat

"Ju propozojmë të vlerësohet nga ju që ky problem të rregullohet me akt normativ, e drejta për të kryer shit-bleje me para në dorë deri në 100.000 lekë për fermerët shqiptarë në pikat e grumbullimit dhe të agro-përpunimit".

## Doganat

"I mbyllin shërbimet doganore në orën 20:00, ndërkohe që kamionët me prodhime bujqësore lëvizin përtej këtij orari. Vonesat dëmtojnë cilësinë e prodhimit dhe theyejnë kontratat e dorëzimit në kohë në destinacion".

son gjenden emergjente tashmë në prag sezoni të kultivimit bujqësor.

## Marrëveshja Shqipëri-Itali, 2 mln € për studim fizibiliteti për disa rrugë

Projektet që dyfishojnë lidhjen rrugore midis Milotit dhe Shkodrës

Qeveria shqiptare dhe ajo italiane nënshkruan marrëveshjen për studimin e terrenit për ndërtimin e tre segmenteve rrugorë të përfshirë në Korridorin Adriatik Jonian dhe në Korridorin e Tetë. Marrëveshja u nënshkrua nga Ministri i Transporteve në emër të Qeverisë Shqiptare dhe nga Ambasadori italian në Shqipëri, Alberto Cuttillo, në emër të asaj Italiane. Ambasadori italian tha se mbështetja e projekteve të rëndësishme rrugorë në Shqipëri ka qenë një prioritet i Qeverisë italiane, si një prej shtyllave kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit. "Marrëveshja që nënshkruam sot është një mjaft e rëndësishme për zhvillimin e infrastrukturës rrugore të Shqipërisë. Është një sektor që Italia e ka konsideruar prioritar që në vitet 1990 dhe i ka parë të dy shtetet të impenjuara së bashku në zhvillimin e tij" tha Cuttillo. Ministri Haxhinasto tha se falë marrëveshjes Shqipëria do të ketë në dorë një



projekt shterues për të tre segmentet mjaft të rëndësishëm për Shqipërinë. "Më konkretisht janë projektet që dyfishojnë lidhjen rrugore midis Milotit dhe Shkodrës. Është projekti që bën evitimin e zonës industriale Tiranë-Durrës, pra lidh Vorën me Kavajën ose Rrogozhinën dhe një

vepër tjetër që është By Passi i Elbasanit". Marrëveshja parashikon fillimisht studimin e fizibilitetit të tre segmenteve si dhe impaktin e tyre në ambient. Konkreisht bëhet fjalë për: 1-Dyfishimin e segmentit rrugor Milot-Shkodër. 2-Projekti që bën evitimin e zonës industri-

ale Tiranë- Durrës, lidh zonën e Vorës me zonën e Rrogozhinës, ose Kavajës, që do të përcaktohet nga fizibiliteti. 3- By-pass i Elbasanit, që është pjesë edhe e korridorit 8. Marrëveshja parashikon një financim prej 2 milionë euro-sh, për Projektimin paraprak, përfundimtar dhe Studimin e Impaktit Mjedisor për 3 projekte. "Bëhet fjalë për një financim prej 2,1 milion eurosh, për të cilin dua të falënderoj ambasadorin dhe Qeverinë Italiane. Pas kësaj do të kemi një projekt integral, pra do të jetë një produkt i gatshëm për tu financuar. Është një metodë e re që aplikohet, duke i përmblodhur gjithë hallkat e realizimit të një projekti, gjë që duhet marrë model edhe në projekte të tjera. Me ambasadorin kemi rënë dakord që të tregojmë fleksibilitetin e duhur, me qëllim që përcaktimi i gjurmës veçanërisht për lidhjen midis zonës së Tiranës ose Kavajës ose të Rrogozhinës, me qëllim të shërbejë më mirë rrjetit tonë të transportit"-tha Haxhinasto.

# Rama takohet në SHBA me kryebashkiakun e Nju Jorkut

## "Në nëntor thërrasim në Tiranë Samitin e Diasporës Shqiptare"

ESIONA KONOMI  
TIRANE

**K**ryeministri Edi Rama u takua me Kryetarin e Bashkisë së Nju Jorkut Bill de Blasio në ditën e parë të vizitës në SHBA. Gjatë takimit me kryebashkiakun e Nju Jorkut, Kryeministri Rama vlerësoi marrëdhëniet e shkëlqyera mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por edhe rolin që SHBA ka luajtur në mbrojtje të interesave kombëtare shqiptare. Nga ana e tij, Kryetari i Bashkisë de Blasio e përgëzoi Kryeministrin Rama për reformat e ndërmarrura nga qeveria shqiptare dhe vlerësoi rolin e diasporës shqiptare në Nju Jork. Kryeministri Edi Rama mori pjesë edhe në një aktivitet të organizuar nga komuniteti shqiptar në Nju Jork. Një takim miqësor ku u fol për Shqipërinë e sotme dhe të nesërme, për marrëdhëniet e veçanta me Shtetet e Bashkuara dhe kontributin e komunitetit shqiptaro-amerikan në zhvillimet e këtyre 25 viteve në Shqipëri. Në takim ka marrë pjesë Prokurori i Përgjithshëm i Shtetit të Neë Jorkut, Eric Schneiderman, si dhe Mark Gjonaj anëtar i Asamblesë së Shtetit të Nju Jorkut. Aty Rama njoftoi edhe një iniciativë të re të qeverisë. Për të fuqizuar lidhjet e diasporës shqiptare kudo nëpër botë me vendim amë, në nëntor të këtij viti në Tiranë do të mbahet Samiti i parë i Diasporës, për të cilin Kryeministri Rama është i bindur se do të krijojë një marrëdhënie të re, përmes hapave konkretë bashkëpunimi. "Unë jam i bindur që mund të bëjmë më shumë dhe më mirë. Jam i lumtur të shpall këtu, për herë të parë, se në nëntor të këtij viti do të organizojmë Samitin e parë të Diasporës Shqiptare në Tiranë. Puna për organizimin e Samitit është në zhvillim dhe shumë shpejt, detajet



për pjesëmarrjen dhe regjistrimin do të bëhen publike. E shkuara jonë e hidhur dhe e përcarë, dekada të mungesës së komunikimit, vrulli për të zbuluar botën dhe vështirësitë e tranzicionit në rindërtimin e shtëpisë sonë na kanë mbajtur shpesh të veçuar. Kjo nuk do të ndodhë më. Samiti do të jetë një event madhor, ku

qeveria dhe aktorë të tjerë kombëtarë do të diskutojnë me përfaqësuesit e diasporës shqiptare nga çdo kënd i botës, në më shumë se 50 vende, për hapat konkretë që mund të hedhim për të forcur lidhjet dhe bashkëpunimin midis nesh. Në radhë të parë, si mund të ndërtojmë sa më shumë ura dijeje, sepse dija është

gjëja më e çmuar që Shqipëria mund të mësojë nga ju këtu dhe nga të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen në botë." – u shpreh Kryeministri Rama. Ky rrugëtim 25 vjeçar i Shqipërisë, edhe pse me një trashëgimi të vështirë, ka shënuar arritje madhore për shqiptarët kudo. "Sot, Shqipëria është një spirancë stabiliteti në Ballkan; një

### TAKIMI

Gjatë takimit me kryebashkiakun e Nju Jorkut, Rama vlerësoi marrëdhëniet e shkëlqyera mes vendeve, por edhe rolin që SHBA ka luajtur në mbrojtje të interesave kombëtare shqiptare.

### DIASPORA

Në nëntor të këtij viti në Tiranë do të mbahet Samiti i parë i Diasporës, për të cilin Rama është i bindur se do të krijojë një marrëdhënie të re, përmes hapave konkretë bashkëpunimi.

anëtare e NATO-s, së bashku me SHBA-në dhe miqtë e partnerët e tjerë, kandidate për anëtarësim në BE; por më shumë se çdo gjë, një demokraci gjithnjë e më të fortë, një shoqëri e lirë, me një kohezion social të admirueshëm, një oaz respekti mes besimeve të ndryshme, diçka që e tërë bota admiron. Nga ana tjetër dua ta them dhe ta përsëris se ne shqiptarët nuk kemi qenë kurrë më mirë me parë, jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë Shqipërisë. Me një tjetër shtet shqiptar, Kosovën e lirë dhe të pavarur." – u shpreh Kry-

eministri Rama. Në këto arritje, për Kryeministrin Rama, mbështetja e fortë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka qenë jetike. Po ashtu, roli i komunitetit shqiptaro-amerikan ka qenë domethënës. Duke folur për qëllimin e organizimit të takimit të diasporës, Kryeministri nënvizoi se ai do të udhëhiqet nga nevojja për të ndërtuar një urë midis shqiptarëve, brenda dhe jashtë, për të bërë më shumë në ruajtjen e gjuhës, imazhit dhe zhvillimit të identitetit tonë, si dhe nga nevojja për të ngritur strukturën e bashkëpunimit.



FOTOLAJMI

### RAMA PRITET ME PROTESTA NË NJU JORK PËR HEC-et NË VALBONË

Kryeministri Edi Rama u prit me protesta në Nju Jork, ndërsa hynte në Muzeun Hebre, ku u zhvillua ceremonia e takimit të tij me diasporën shqiptare në SHBA. Në fillim të aktivitetit, ajo që ra në sy ishte një grup ambientalistësh shqiptarë dhe amerikanë, të cilët e kishin menduar ndryshe pritjen e Kryeministrit të Shqipërisë, duke protestuar me pankarta në duar "EDI RAMA NO HYDROPOËER IN VALBONA".

### Akuzat TIRANE

**M**imoza Hafizi e Ben Blushi angazhohen se do të takojnë çdo socialist që figuron se ka votuar në referendumin e 9 prillit, për tu treguar se edhe pse nuk kanë votuar, ata figurojnë si pjesëmarrës në referendum. "Referendumi i 9 Prillit ishte një proces me shkëlqje të panumërta ligjore, ku u kërkuua të shpreheshin me dhjetëra mijë socialistë". Kështu shprehet deputetja e Partisë Socialiste, Mimoza Hafizi, duke akuzuar për deformim të votës së anëtarëve socialistë. Ajo theksoi se i ka kërkuar komisionit zgjedhor në PS, t'i dorëzojë fotokopjet e të gjitha listave të pjesëmarrësve në procesin e votimit, me nënshkrimet e votuesve,

në 385 qendrat e votimit të vendit. "Ne i ftuam socialistët t'i thonë 'Jo' këtij procesi, me argumente të zhvilluara përgjatë 3 javëve pas Kongresit. Si të tillë, ne ishim alternativa referendare. Në Kodin Zgjedhor të Partisë, neni 55.6, si alternativë referendare ne kishim të drejtën e vëzhgimit të procesit. E kemi kërkuar që në ditën e parë, publikisht. Një ditë para referendumit, unë kam ndjekur gjithkund Komisionin Zgjedhor të Par-

tisë Bashkia Shkodër, për t'i kërkuar akreditimin e vëzhguesve në 11 qendrat e votimit në këtë bashki. Komisioni është fshehur, është ndërruar në momentin e fundit, nuk më është përgjigjur. Për këtë kam dokumentim të plotë. Ne nuk na u dha mundësia të kemi vëzhgues, për të shënuar se cilët ishin pjesëmarrësit realë në procesin e votimit. Në këto kushte, është detyrim ligjor që të na plotësohet kërkesa: të na vihen në dispozicion fotokopjet

e të gjitha listave të pjesëmarrësve në procesin e votimit, me nënshkrimet e votuesve, në 385 qendrat e votimit të vendit. Kërkesën do ia parashtrijmë KZP, Komisionit Zgjedhor të Partisë, sapo ky komision të shpallë rezultatin e referendumit, kuti për kuti, ashtu siç e kërkon Kodi Zgjedhor i Partisë", u shpreh Hafizi. Ajo deklaroi se bashkë me deputetin Blushi do të nisë një tur takimesh me anëtarësimin e socialiste në rrethe. "Me këto

## Hafizi: Do tu tregojmë socialistëve si u manipulua referendumi i 9 Prillit

### Hafizi e Blushi premtojnë verifikim derë më derë të socialistëve që thuhet se votuan



Mimoza Hafizi dhe Ben Blushi

lista në dorë ne do shkojmë të kontaktojmë të gjithë socialistët shqiptarë, qytet më qytet e fshat më fshat, për t'u treguar sesi emrat e tyre janë abuzuar dhe se sa i shëmtuar dhe i manipuluar ka qenë ky proces. Është detyra jonë morale para socialistëve dhe

shqiptarëve", tha ajo. Edhe deputeti tjetër kritik, Ben Blushi akuzoi një ditë më parë për manipulimin e procesit të referendumit. Ai akuzoi se komisioni zgjedhor nuk i ka vënë në dispozicion materialet zgjedhore të votimit të anëtarësisë në 9 Prill.

# FRESSH i çon lekët e mbledhura ditën e referendumit, Ina Ballës

Paratë i janë çuar Inës nga të rinjtë që ndërморën nismën



Sara Balla, vajza e vogël e Inës

Nismës për të ndihmuar Ina Ballën, nënën që vuan nga kanceri i gjirit, i janë bashkuar edhe të rinjtë e FRESH në njësinë nr.8. Pas apelit në Report TV jo vetëm qytetarët por edhe aktivistët të partive politike janë sensibilizuar për të ndihmuar Inën dhe dy vajzat e saj. Në ditën e referendumit për mandatin e kryetarit të PS kanë kutive të votimit në njësinë nr.8 qëndronte edhe një kuti për të mbledhur lekë për Ina Ballën. Këto para i janë çuar Inës nga të rinjtë që ndërmoren këtë nismë. Ina Balla sot do të bëjë kimioterapi, për të parë gjendjen e saj si dhe për të mësuar kurën që do përdorë. Vet ajo thotë se ka

shumë besim se do t'ja dalë, pasi tani mendon vetëm për sëmunden dhe jo më për gjendjen ekonomike. "Jam qetësuar nga gjendja shpirtërore, jam përqendruar tek sëmundja. Jam qetësuar se më kanë ndihmuar shumë njerëz. I falënderoj të gjithë. Besoj se do t'ia dal. Shpresa vdes e fundit," u shpreh ajo. Përgjatë këtyre ditëve ndihmat për Ina Ballën nuk kanë munguar. Menjëherë sapo Report TV tregoi gjendjen e vështirë në të cilën ajo ndodhej, Bashkia e Tiranës vendoi t'i paguajë qiranë, ndërsa Spitali Onkologjik do t'i bëjë të gjitha analizat falas. Vajza e vogël e Ina Ballës, Sara, ka një mesazh për të gjithë ata që i kanë ndihmuar. "I falënderoj të gjithë".



Të rinjtë e FRESH në shtëpinë e Ina Ballës



# SHBA nis punën për njohjen e pensioneve me Shqipërinë

Kreu i ISSH-së Astrit Hado në Kuvend: Kemi filluar shkëmbimin e informacionit teknik

ESIONA KONOMI  
TIRANE

Shtetasve shqiptarë që jetojnë në Amerikë dhe amerikanëve që punojnë në Shqipëri, do tu njihen shumë shpejt vitet e punës në mënyrë të ndërsjellët mes dy vendeve për efekt të pensionit. Lajmi bëhet i ditur nga Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurime Shoqërore, Astrit Hado në Komisionin e Politikës së Jashtme. Hado tha se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë shprehur interes për njohjen e ndërsjellët të kontributeve, dhe për këtë ka filluar puna e shkëmbimit të informacionit dy palësh. "Dua të vë në dijeni komisionin për një informacion që mund të jetë i vlefshëm. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë shprehur interes për njohjen e kontributeve të shtetasve në mënyrë të ndërsjellët. Ne kemi filluar tashmë shkëmbimin e informacionit teknik dhe sinjalet janë pozitive për arritjen e një marrëveshjeje sa më shpejt. Do të ishte një lajm i mirë, pasi dihet që komuniteti shqiptar atje është i konsiderueshëm", tha Hado. Diskutimi i një çështjeje të ngjashme, për njohjen e pensioneve me Rumaninë u diskutua dhe në Komisionin e Çështjeve Sociale. Në fjalën e tij, Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurime Shoqërore, Astrit Hado u shpreh se kjo marrëveshje është hartuar në përputhje me rregulloren 83 të Bashkimit Evropian. Hado deklaroi se nga kjo marrëveshje pritet të përfitojnë rreth 1500 qytetarë që jetojnë në Ruman. Gjithashtu, Hado theksoi se: "Parimi i kësaj marrëveshjeje është trajtimi i barabartë i shtetasve të të dy vendeve dhe në funksion të lëvizjes së lirë të kraut të punës, parimi i dytë është totalizimi i

## Kontributet

Ne kemi filluar tashmë shkëmbimin e informacionit teknik dhe sinjalet janë pozitive për arritjen e një marrëveshjeje sa më shpejt



Astrit Hado, Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurime Shoqërore

periudhave kontributeve për efekt të plotësimit të kushteve për të përfituar një pension sipas legjislativës të zbatueshëm të të dy vendeve, si dhe eksportimi i përfitimeve të gjithë qytetarët që banojnë në vendet respektive të kenë të drejtën e pagimit të përfitimeve në vendin ku ata banojnë". Pas diskutimeve, Nënkyretarja e Komisionit për Punën, Çështjet

Sociale dhe Shëndetësinë, Klodiana Spahiu, falënderoi për punën që Institutit i Sigurimeve Shoqërore ka bërë për nxitjen kohët e fundit për të kaluar këto marrëveshje për mbrojtjen shoqërore në ato vende ku ka shtetas shqiptarë. "Ne jemi gjithmonë në pritje të dy marrëveshjeve kryesore me dy shtetet ku dhe numri i shtetasve shqiptar është më i madh, me Italinë

dhe me Greqinë. Edhe kjo marrëveshje me Rumaninë, pavarësisht se janë vetëm 1500 shtetas shqiptarë, është e rëndësishme sepse tregon angazhimin e institucionit tuaj dhe qeverisë për mbrojtjen shoqërore të gjithë shtetasve të saj kudo që janë", tha Spahiu. Me ardhjen e të majtëve në qeveri, ministri i atëhershëm, Erion Veliaj nisi një tur bisedimesh

## SHPERBLIMI

Pagesa për bebet e lindura, përfitojnë vetëm të lindurit pas 1 Janarit 2016



Fëmijët e lindur nga qershori 2012-t deri në dhjetor 2015-t nuk do të marrin shpërblimin prej 5 mijë lekë nga Bashkia e Tiranës. Pagesa nuk do jetepër shkak se administrata e ish-kryebashkiaku Lulzim Basha nuk e ka parashikuar në buxhet bonusin e bebeve. Kjo do të thotë se shpërblimi prej 5 mijë lekë nga bashkia e kryeqytetit do të jetepvetëm për bebet e lindura nga 1 janari 2016-t. Bashkia e Tiranës bëri të ditur se duke qenë se nuk është parashikuar në buxhet pagesa për vitet 2012-2015 ajo nuk mund të paguhet. Ka qenë ish-kryebashkiaku Lulzim Basha i cili nuk parashikoi në buxhet këtë pagesë në vitin 2012. E njëjta gjë ndodhi përgjatë gjithë mandatit të tij, duke bërë që mijëra nëna të mos marrin bonusin e bebeve prej 5 mijë lekë. Kjo pagesë u vendos për herë të parë nga ish-kryebashkiaku Edi Rama në vitin 2008 dhe është rikthyer nga Erion Veliaj. Ky i fundit në datën 1 janar i ka çuar vet nënës që lindi fëmijën e parë për 2016-n, çekun me 5 mijë lekë të rinj.

për njohjen e pensioneve me disa shtete, ku u nënshkrua marrëveshja me Maqedoninë, Çekinë, Kanadanë, Hungarinë, etj. sikundërse bisedimet intensive kanë filluar edhe me Gjermaninë dhe Italinë.



**PROCEDURA**

Të gjitha këto procedura pritet të zgjatin rreth një muaj e gjysëm dhe debitë ish-ushtarake do të falen pas datës 1 qershor 2016

**DEBIA**

Për ish-ushtarakët, të cilëve dokumentacioni i rillogaritjes u dërgua më shpejt, vlera debitoare ka qenë më e ulët dhe tashmë debia është shua

# Falja e debive, ja kur do përfitohet dhe si do llogaritet

Ish-ushtarakeve debitë u falen nga qershori. Ministria: Jo rillogaritje për pensionet

**P**avarësisht se qeveria ka miratuar projektligjin për faljen e debive të ish-ushtarakeve, përfitimi do të jetë duke filluar nga muaji qershor. Kjo për shkak se projektligji ende nuk ka filluar diskutimet në komisionet parlamentare, që më pas të votohet në Parlament. Gjithashtu projektligji do të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Të gjitha këto procedura pritet të zgjatin rreth një muaj e gjysëm dhe debitë ish-ushtarakeve do të falen pas datës 1 qershor 2016. Të kontaktuar nga "Shqiptarja.com", përfaqësuesit e shoqatave u shprehën se prisnin që debitë të falehin në një kohë të shkurtër dhe jo disa muaj, pasi

të jepej lajmi. Ndërkohë nga falja e debive pritet të përfitojnë rreth 5500 ish-ushtarakët që gjatë viteve të fundit u është mbajtur një pjesë e pensionit.

**PËRFITUESIT**

Një pjesë e ish ushtarakeve tashmë e kanë paguar debinë, e cila nuk do t'ju kthehet më. Ndërsa një pjesa tjetër kanë ende një vlerë të lartë për të paguar. "Bazuar në vendimin nr.793, datë 24.9.2010, të ndryshuar, rillogaritja e përfitimeve është mbi bazën e një Modelarit 03 "Vërtetim për vjetërsinë në shërbim dhe pagën neto mesatare referuese", dokument i cili, plotësohet nga strukturat e ministrive të linjës dhe

më pas përcillet zyrtarisht pranë strukturave rajonale të sigurimeve shoqërore, që zbatonin procedurën e llogaritjes apo rillogaritjes së përfitimit. Këto dokumente janë dërguar zyrtarisht në strukturat e sigurimeve shoqërore, fillimisht në 2010 dhe më pas nga 2011, e akoma vijojnë të dërgohen. Për ish-ushtarakët, të cilëve dokumentacioni i rillogaritjes u dërgua më shpejt, vlera debitoare ka qenë më e ulët dhe tashmë debia është shuar, ndërkohë që për një numër të konsiderueshëm të ushtarakeve, të cilët kanë edhe gradë më të ulët, (mënoficer), për të cilët dokumentacioni është dërguar më me vonë, e për disa të tjerë dokumentacioni të cilëve

ende nga ministrinë e linjës nuk u është nxjerrë dhe dërguar, vlera debitoare rezulton të jetë mjaft e lartë", - thuhet në relacionin e projektligjit për faljen e debive për ish-ushtarakët.

**RILLOGARITJA**

Pas projektligjit për faljen e debive për ish-ushtarakët një tjetër kërkesë e shoqatave të rezervistëve është edhe shfuqizimi i aktit normativ i miratuar nga ish-qeveria "Berisha" në vitin 2010. Por të kontaktuar nga "Shqiptarja.com" Ministria e Mirëqenies Sociale u shpreh se nuk ka një iniciativë për të rrezuar këtë akt apo për një formulë të re llogaritje për ish ushtarakët.



**SA PERSONA DO PERFITOJNE**

Deri 25 mijë lekë	934 persona
25-50 mijë lekë	668 persona
50-100 mijë lekë	862 persona
100-150 mijë lekë	609 persona
150-200 mijë lekë	466 persona
200-250 mijë lekë	512 persona
250-300 mijë lekë	426 persona
300-350 mijë lekë	272 persona
350-400 mijë lekë	210 persona
Mbi 400 mijë lekë	466 persona



Blendi Klosi dje në Lushnje

**LUSHNJE/ AKTUALISHT, VETEM RRETH 53% E NJESIVE ADMINISTRATIVE**

## Ministri Blendi Klosi: Qendra për mbrojtjen e fëmijëve në çdo bashki

**A**utobuzi me mbishkrimin "Unë Mbroj Fëmijët" ka qarkulluar dje në rrugët e qytetit të Lushnjes, nga ku nisi sot faza e dytë të fushatës me të njëjtin slogan. I pranishëm në Lushnje, ishte sot dhe ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Blendi Klosi, i cili morri pjesë edhe në ceremoninë e inaugurimit të qëndrës së re të Zhvillimit në Bashkinë Lushnje, që do të ndihmojë fëmijët me nevoja të veçanta. Klosi tha se ligji i

ri i mbrojtjes së fëmijëve, që do ta propozohet në datën 1 qershor, "do të detyrojë të gjitha bashkitë në vend, të ngrenë Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, që do jenë të shtrira në të gjithë vendin". "Aktualisht, vetëm rreth 53% e njësive administrative të vendit", deklaroi ministri. Njësitë e ngritura pranë bashkive, janë përgjegjëse për ndjekjen e çdo rasti të fëmijëve në situata rreziku, të fëmijëve në rast dhune, abuzimi apo neglizhimi, shtoi Klosi.



Autobuzi me mbishkrimin "Unë Mbroj Fëmijët"

**OFERTË PUNËSIMI**

Kompania mediatike Shqiptarja.com kërkon të punësojë menaxher marketingu që plotëson kriteret e mëposhtme:

- Të ketë arsim të lartë
- Të ketë përvojë pune
- Të jetë i gatshëm për të punuar në terren

Personat e interesuar të dërgojnë CV e tyre në adresën: [marketing@shqiptarja.com](mailto:marketing@shqiptarja.com)

**Borxhi 1 milionë euro  
Luftë institucionesh, Tatimet  
bllokojnë lekët e Ujësllësit në Kukës**

**L**logaritë bankare të drejtorisë së Ujësllësit Kanalizimeve Kukës janë bllokuar për shkak të një borxhi rreth 1 milion euro të akumuluar nga taksat e papaguara. Ngriria e parave ka ardhur pas një urdhër-blokimi të depozituar në të gjitha bankat që operojnë në vend, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës. Mësohet se debia rreth 1 milion euro është krijuar gjatë një harku kohor prej 8 vitesh. Gjatë kësaj kohe, drejtoria e ujësllësit nuk ka paguar kontributet shoqërore

të punonjësve dhe detyrime të tjera tatimore. Veç mungesës së investimeve në Ujësllësin e Kukësit, tashmë ky bllokim duket se e ka paralizuar tërësisht ndërmarrjen. Drejtoria e ujësllësit dhe Bashkia Kukës kanë nisur negociatat, por mësohet se nuk është arritur ende një marrëveshje me Drejtorinë e Tatimeve. Ujësllësi i Kukësit është tërësisht i pamundur financiarisht për të paguar këtë debi, që është krijuar si pasojë e neglizhencës edhe të organeve tatimore.

# Akuzat për Gërdecin, Mediu për Tahirin: Ministër i marrë

“Duhet sanksionuar, moslejimi i kapërcimit të deputetëve nga një krah në tjetrin”



Fatmir Mediu dhe Denis Minga në emisionin "45 minuta" në Report TV

**DENIS MINGA**  
TIRANE

Kryetari i Partisë Republikane Fatmir Mediu e cilësoi të marrë ministër e Brendshëm Saimir Tahiri pas akuzave që ky i fundit bëri ndaj tij si një nga përgjegjësit e tragjedisë së Gërdecit. Në 8 vjetorin e kësaj ngjarje Tahiri pati deklaruar se një nga autorët e tragjedisë, sot na flet për reformën në drejtësi. Deklarata e kreu të PR-së u bë në emisionin 45 minuta në Report TV. “Fakti i keq i këtij vendi është që ka një të marrë ministër të Brendshëm. Tahiri nuk vlen ta komentoj. Është ai që është. Ai se ka problem të shkel ligjin. Ai meriton që t'i kthehem ndryshe, por unë kam respekt për qytetarët. Kanë gjithë shoqëria shqiptare fakte për Saimir Tahirin. Ai kujton se është dhe prokuror dhe gjyqtar. Saimir

Tahiri duhet të bëjë rolin e ministrit dhe të mos bëj rolin e gjyqtarit,” tha Mediu. Gjithashtu, Mediu foli dhe për kushtet e opozitës për të pasur marrëdhënie normale me Parlamentin. Ai deklaroi se nëse mandatet e tre deputetëve shkojnë në Gjykatë Kushtetuese, opozita do të rikthehet në Parlament. “Padyshim që do kthehemi në tryezë. Gjykimi im është që po. Po kjo nuk duhet të na bëjë ne që të mbyllim sytë që për hatër të reformës të lëmë që zhvillimet politike në vend të rreshqasin në drejtimin e gabuar,” u shpreh ai. Përsa i përket Reformës Zgjedhore Mediu përsëriti qendrimin e tij për lista të hapura si dhe votim e numërim elektronik. Po ashtu ai kërkoi që të sanksionohet me ligj, ndalimi i kalimit të deputetëve nga një forcë politike tek tjetra.

**PER TAHIRIN**

Tahiri nuk vlen ta komentoj. Është ai që është. Ai se ka problem të shkel ligjin. Ai meriton që t'i kthehem ndryshe, por unë kam respekt për qytetarët.

“Duhet sanksionuar, moslejimi i kapërcimit të deputetëve nga një krah në tjetrin. Lëvizja e subjekteve nuk ka ndodhur për bindje politike, por interesa korruptive, materialiste. Do ishte më e drejtë që të vendosim rregull që nëse votohem nga elektorati i djathtë s'ka si të mbështesë të majtën. Individët përfaqësues të mos lëvizin sipas pazarit të momentit, që kuvendi të kthet si pazard i gjësë së gjallë,” deklaroi kreu i PR. Po kështu kreu i partisë Republikane ka folur edhe për problematikën që ka aleanca opozitare pas disa divergencave mes partive. “Balli Kombëtar dhe Legaliteti kanë qenë present në mbledhjen e djeshme të aleancës. Disa nga problemet lokale vijnë nga mënyra e ndërtimit të koalicionit. Kam kërkuar dhe kam diskutuar me kolegë të tjerë të partive, disa elemente thelbësorë

për reformën zgjedhore dhe momente të tjera”, u shpreh Mediu. I pyetur për mënyrën se si e sheh kreu i Opozitës, Basha atë dhe partinë e tij si aleat si partner apo si një e keqe e domosdoshme për zgjedhje, Mediu tha se: “Nëqoftëse do shikoja sinjalin më të vogël se na shikojnë si e keqe e domosdoshme nuk do isha unë dakort për raportin. Marrëdhënia ka qenë si shkak i angazhimeve të përbashkëta. Vlera e peshës e PD nuk mund të zëvendësohet nga peshës e PR. Jemi në diskutime të vazhdueshme. Kam dhe një përgjegjësi shtesë. Nuk jam nga ata që kur ishim në koalicion në kohën e qeverisjes të isha në një mendim dhe tani që jemi në opozitë, të shoh interesat. Ne kemi kërkuar, që e djathta të mos shikohet si një e djathtë e PD, PR apo disa elementëve të tjerë. Është më e gjërë se kaq, është e djathta e partive historike, por edhe e të reja, si dhe e grupeve të interesave”, tha kreu i PR-së.

**KREU I FRPD**

**Këllçi me të rinjtë europianë: Në Shqipëri, papunësia 33%**



Kryetari i Forumit Rinor të Partisë Demokratike, Belind Këllçi ka marrë pjesë së fundmi në punimet e DEMYC, komunitetit të të rinjve europianë, në Shkup të Maqedonisë. “Këllçi ndau me delegatët nga e gjithë Europa shqetësimin e tij dhe të rinjve demokratë shqiptarë për situatën e rëndë ekonomike, papunësinë e të rinjve e cila kap shifrat zyrtare 33%, procesin e dekriminalizimit, i cili do të ndalë promovimin e njerëzve me të shkuar kriminale si dhe eksodin masiv të shqiptarëve. Nga ana tjetër, ai informoi të rinjtë Europianë mbi modelin tjetër të cilin ofron Partia Demokratike dhe kryetari Basha i cili që prej fillimit, i ka kushtuar një rëndësi të veçantë promovimit të të rinjve në parti”, thuhet në një njoftim të Partisë Demokratike. Këllçi zhvilloi edhe takime me të rinj e zyrtarë në Maqedoni e Kosovë. “Në përfundim të vizitave në Trevat Shqiptare me përfaqësues të Forumeve Rinore nga Maqedonia, Kosova dhe Presheva u ra dakord për fillimin e bashkëpunimit midis Forumeve Rinore, shkëmbimin e eksperiencave, trajnimin e përbashkët dhe për mundësinë e organizimit në muajt që vijnë të një takimi në Tiranë me të gjithë përfaqësuesit e Forumeve Rinore të Trevave Shqiptarë”, përfundon njoftimi i PD-së.

**DEKLARATA/ NENKRYETARI I KUVENDIT, EDMOND SPAHO: TRUK I SHUMICËS**

## Konferenca e Kryetarëve nuk pranon hetimin e CEZ

Konferenca e Kryetarëve nuk ka pranuar sot kërkesën e Partisë Demokratike për ngritjen e një komisioni hetimor, me qëllim hetimin e marrëveshjes së qeverisë shqiptare me kompaninë CEZ. Kërkesa e demokratëve u depozitua një javë më parë, duke pretenduar se nga marrëveshja i është shkaktuar buxheti të shtetit një dëm financiar prej 500 milionë euro. Por në mbledhjen e sotme, Konferenca e Kryetarëve nuk ka marrë një vendim për kërkesën e opozitës, kjo pasi mazhoranca ka kërkuar që objekt i komisionit hetimor të jetë edhe nënshkrimi i marrëveshjes së privatizimit. Nën-kryetari i Kuvendit, deputeti i PD, Edmond Spaho akuzoi mazhorancën se përdor truke për të penguar punën e opozitës. “Mazhoranca vazhdon me praktikën e vjetra të kundërshtimit të iniciativave të opozitës për të ngritur komisione hetimore parlamentare me argumentet që janë adresuar njëherë e mirë nga Gjykata Kushtetuese, si argument që paralelisht po heton edhe prokuroria për këtë çështje. Gjykata Kushtetuese është shprehur në vitin 2014 në rastin e kërkesës për komision hetimor për serverin e tati-meve. Mazhoranca përdor truke duke propozuar që komisionit hetimor të propozuar nga ne t'i zgjerohet fusha e aktivitetit duke hetuar edhe marrëveshjen për privatizimin e CEZ dhe

zbatimin e kësaj marrëveshje gjatë viteve që funksionoi privatizimi”, u shpreh ai. Spaho tha Kuvendi ka një mundësi të dytë të hënën që të votojë ngritjen e komisionit. Ai shtoi se opozita do të japë votën e saj. “Është e drejta e mazhorancës ta kërkojë këtë komision, ne do t'i japim edhe votat e opozitës që të ngrihet dhe mazhoranca të hetojë çdo gjë që ka për të hetuar. Ka pasur kohën në periudhën kur ishte në opozitë, por nuk e ka ngrit-

ur, por tani ka më shumë mundësi ta ngriej, por me këto truke nuk mund të pengojë punën e opozitës për të hetuar zgjidhjen me mirëkuptim mes qeverisë shqiptare dhe CEZ. Nuk pati mirëkuptim nga mazhoranca për të respektuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe ula që të arrihet deri të enjten që të mund të konsultohen me mirë vendimet e gjykatës kushtetuese dhe të vinë me një mendim të ri të enjte”, deklaroi Spaho.



Edmond Spaho

**Deklarata e PD**

**“Tenderi i TVSH, firma u paracaktua 8.8 mln € klientit të qeverisë”**

Sekretarja për Marrëdhënie me Publikun në Partinë Demokratike, Grida Duma, akuzoi sot qeverinë se ka dhënë 8.8 milionë euro për mirëmbajtjen e rrjetit dixhital të TVSH pa tender dhe pa garë. Sipas saj, kontrata i është dhënë një kompanie të afërt me qeverinë. “8.8 milionë euro me një dorë, pa tender e pa garë. Kjo është goditja e radhës e Edi Ramës që ka vendosur të ndajë këtë shumë marramendëse me oligarkët e tij, për mirëmbajtjen e rrjetit dixhital të Radio Televizionit Shqiptar. Mazhoranca në Këshillin Drejtues të RTSH, nën urdhërat e Edi Ramës ka miratuar javën që kaloi këtë kontratë të dyshimtë, me vlerë 8.8 milionë

euro. Kontrata, e cila i është paraqitur Këshillit Drejtues që në muajin gusht të vitit 2015, paracaktonte si përfituese kompaninë IDEA-Tel, një firmë e afërt me ministrin e deputet të mazhorancës aktuale”, u shpreh Duma. Sipas saj, megjithë debatet dhe kundërshtimet në Këshill, dhe kërkesën e shumë anëtarëve për organizimin e një tenderi të hapur dhe konkurrues, apo për kualifikimin e stafit të RTSH, për ta realizuar ata, mirëmbajtjen e rrjetit dixhital, duke kursyer kështu miliona euro të taksapaguesve shqiptarë, gjithçka ka qenë e kotë pasi Edi Rama e kishte vendosur t'ia jepte, me saktë të ndante me klientin e tij 8.8 milionë euro.

# Veliaj: Nishani, i vetmi me vilë në park e eskortë në pedonale

Kryetari i Bashkisë së Tiranës reagoi ashpër pas takimit të Presidentit

**P**as takimit të Presidentit Bujar Nishani me një përfaqësi të shoqërisë civile mbi ndërtimin e këndit të lojërave në parkun e Liqenit Artificial, ka reagoi kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj. Në një postim të tijin në "twitter", kryebashkiaku Veliaj i përgjigjet Nishanit pas mbështetjes që ky i fundit i premtoi shoqërisë civile në kauzën e tyre, duke e quajtur të turpshëm përfshirjen e tij në debatin për këndin e lojërave. "Bota ka parë Kryetar Bashkie të dojë të bëhet President, por president të bëhet kryetar bashkie veç Tirana po sheh! Sa turp që do t'u prishë parkun femijëve! Z.Nishani i vetmi shtetas që jeton me vilë në Park e eskortë në pedonale," shkruan Veliaj duke e shoqëruar postimin e tij edhe me një foto nga eskorta e Nishanit. "Lodrat do bëhen! Nëse Nishani ka vilë në Park, edhe femijët do kenë këndin. 200,000 femijët e Tiranës vlejnë më shumë se urdhrat e Partisë Demokratike, i dashur President", përfundoi Veliaj.

**NISHANI: PARKU, SENSIBILIZIM PA DALLIME**  
Një përfaqësi e aktivistëve



Erion Veliaj dhe Bujar Nishani

të cilët janë kundër ndërtimit të parkut të lodrave për femijë në liqenin artificial, kanë zhvilluar dje një takim me Presidentin e vendit Bujar Nishani të cilit i kanë kërkuar që Këshilli i Lartë i Drejtësisë të ndjekë kalvarin e gjyqit të nisur ndaj kësaj

çështje, ndërkohë që kanë shtuar se do të shkojnë edhe në Gjykatën Kushtetuese. Anëtarët e grupimit qytetar ftuan Kreun e Shtetit për të vizituar nga afër vendin ku po zhvillohet projekti ndërtimor në një kohë të përshtatshme. Menjëherë pas takimit,



## Kryetari

"Bota ka parë Kryetar Bashkie të dojë të bëhet President, por president të bëhet kryetar bashkie veç Tirana po sheh! Sa turp që do t'u prishë parkun femijëve! Z.Nishani i vetmi shtetas që jeton me vilë në Park e eskortë në pedonale,

## Presidenti


Nga ana e tij, Kreu i shtetit ka theksuar se "kjo kauzë dhe të gjithë elementët që kanë dalë prej saj duhet të sensibilizojnë e motivojnë të gjithë aktorët e shoqërisë; politikbërës dhe qytetarë, pa dallime"

përfaqësuesit e pranishëm në këtë takim kanë thënë se Presidenti Nishani i ka premtuar mbështetje ndaj kauzës së tyre. "Arsyeja pse erdhëm është se ne nuk kemi gjetur mbështetje nga institucionet e tjera pas një rrugëtimi shumë të gjatë. Sepse figura e Presidentit është figura më e lartë dhe morëm garanci nga ai që ta ndjekë këtë kauzë. E kemi ftuar që të vijë e të shikojë vendin tek Parku. KLD do ta ndjekë këtë çështje dhe nëse është e nevojshme do shkojmë në Gjykatën Kushtetuese", kanë thënë ata. Nga ana e tij, Kreu i shtetit ka theksuar se "kjo kauzë dhe të gjithë elementët që kanë dalë prej

saj duhet të sensibilizojnë e motivojnë të gjithë aktorët e shoqërisë; politikbërës dhe qytetarë, pa dallime". Presidenti i Republikës shprehu gjithashtu shqetësimin e tij ndaj mungesës së reagimeve të institucioneve shtetërore por edhe shoqërisë civile, për të marrë përsipër secila palë detyrat e angazhimit përkatës në raste të tilla. Nishani u kërkoi përfaqësuesve të qytetarëve të angazhuar në këtë kauzë për të vijuar dhe shprehur lirisht mendimin e tyre në mbrojtje të çështjeve të mjedisit, por edhe për ligjshmërinë e të gjithë procesit të ndjekur për projektin ndërtimor në brendësi të parkut të Liqenit në Tiranë.

## DURRËS

**Pas ankesat të banorëve për ujën, nis puna për tubacionet e reja**




Pas ankesat të përsëritura të qytetarëve durrësa, ndërmarrja e Ujësllës Kanalizime Durrës ka ndërhyrë për përmirësimin e infrastrukturës. Pas shtrirjes së tubacionit të ri të furnizimit me ujë të pijshëm për një pjesë të lagjes nr 1 të qytetit të Durrësit, ndërmarrja e Ujësllës Kanalizime ka nisur punën për të bërë të njëjtën gjë në krahun tjetër të rrugës "Taulantia", në mënyrë që të krijohet sistemi unazë për furnizimin e zonës me ujë të pijshëm. Aktualisht, zona në fjalë furnizohet me ujë të pijshëm nga një linjë e përbërë nga tubacion çeliku me diametër 100 mm dhe banorët kanë shprehur shpesh ankesa për ndotje të ujit dhe mungesë të tij. Me fonde të vetë ndërmarrjes po mundësohet vendosja e tubacioneve 140 mm dhe 160 mm në secilin nga trotualet e rrugës "Taulantia", duke filluar nga muzeu arkeologjik deri tek "Aragosta". Inxhinieri i Ujësllës Kanalizime Durrës, Gerald Dautaj tha se me këtë investim modest përmirësojmë ndjeshëm furnizimin me ujë të lagjes nr 1 dhe sistemi unazë mundëson dërgimin e ujit me presion edhe në ato pjesë të kësaj zone që kanë pasur probleme në të kaluarën. Paralelisht me shtrirjen e tubacioneve të reja, punonjësit e mirëmbajtjes së linjës pranë UKD-së po heqin linjat e vjetra duke i shkëputur ato nga rrjeti i furnizimit me ujë për zonën e Vollgës.

## TIRANË / KRYEBASHKIAKU VELIAJ PREZANTON PROJEKTIN

**'Të ardhurat nga taksa e pronës u rritën nga 7% në 94%'**

**B**ashkia e Tiranës ka rritur të ardhurat e saj si takon taksës së pronës nga 7 % që ishte dikur në 94%. Kështu ka deklaruar dje kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj teksa mori pjesë në takimin organizuar nga Ministria e Zhvillimit Urban me donatorët që mbështesin hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore për 31 bashkitë e para që janë përfshirë në këtë proces. Ai ka sjellë në vëmendje se, falë disa vendimarrjeve të domosdoshme, arka e Bashkisë së Tiranës është përmirësuar ndjeshëm. "Falë një bashkëpunimi me USAID-in, me të cilin kemi lidhur një memorandum në mënyrë që taksat lokale të mblihdhen me faturën e ujit, muaji mars ka



Erion Veliaj

qenë muaji i parë ku Bashkia e Tiranës ka mbledhur më shumë të ardhura nga parkingu dhe nga taksa e pronës se nga taksa e infrastrukturës

së ndërtimit. Kur morëm detyrën, taksa e pronës mblihdhej në nivelin 7%. Brenda një muaji shkoi nga 7% në 94%, pra praktikisht të gjithë ata që

kanë një faturë uji paguajnë taksën e pronës", u shpreh Veliaj. Veliaj, në cilësinë edhe të kreut të Shoqatës për Autonomi Vendore, ka vlerësuar Planin e Përgjithshëm Vendor si një nga instrumentet kryesore të zhvillimit të bashkive, të cilat tashmë përfaqësojnë të gjitha realitetet urbane dhe rurale. Ai theksoi gjithashtu se është e rëndësishme që PPV-të të mos trajtohen si plane që përfaqësojnë vendet ku do të bëhen ndërtime apo pallate, njollat apo koeficientet e shfrytëzimit. Kjo pasi, sipas tij, ato janë një vizion strategjik që përfaqëtojnë një kornizë të qartë të ndërhyrjeve, nevojave dhe potencialit për zhvillim të bashkisë. "Në Tiranë kemi marrë përgjegjësinë e këtij procesi, për

të sqaruar qytetarët, por edhe njëri-tjetrin, se Plani i Përgjithshëm Vendor nuk është instrument për të dhënë lejedërtimi. Sinonimi i derisotëm i Planeve të Përgjithshme Vendore kanë qenë platformat mbi të cilët bëhej kërdia urbane për të dhënë lejet e ndërtimit. Sot besoj, edhe me një lloj frymëmarrje që qeveria qendrore i dha çështjes së ndërtimit në Shqipëri dhe hapësirave publike, kemi arritur në një nivel tjetër emancipimi", deklaroi Veliaj. Aika theksuar se për zhvillimin e njëjësive vendore, përfshi edhe realizimin e planeve të përgjithshme vendore, bashkitë duhet të diversifikojnë të ardhurat, të gjejnë burime alternative financimi dhe të mos presin vetëm nga të ardhurat e Buxhetit të Shtetit.

# Trafikonte makina luksoze, gjykata liron anëtarin e këshillit bashkiak

## Gjykata zbeh operacioni "Lux" në Shkodër liron të gjithë personat e arrestuar

ELTON QYNO  
TIRANE

Gjykata e Shkodrës ka liruar nga qelia, anëtarin e Këshillit Bashkiak në Bashkinë e Malësisë së Madhe, Bujar Hasa, i arrestuar për trafik të 22 automjeteve luksoze nga vendet e BE në Shqipëri. Në bazë të prova të grumbulluara nga prokuroria e Shkodrës, Hasa ishte drejtuesi kryesor i këtij grupi, ku në bashkëpunim edhe me dy persona të tjerë si Naim Hasa dhe Tonin Marku nga Malësia e Madhe, kanë trafikuar automjete luksoze dhe më pas i kanë shitur ato, duke përdorur dokumenta të falsifikuar. Mirëpo pavarësisht provave bindëse që prokuroria e Shkodrës kishte administruar për këtë tre persona, gjyqtarja e Shkodrës Luveta Dade, ka vendosur të lirojë nga qelia tre shtetasit Bujar Hasa, Tonin Markun dhe Naim Hasa. Për këta persona, prokuroria kërkoi caktimin e masës "arrest në burg" pasi rezultojnë me veprime aktive kriminale në trafikim e automjeteve luksoze. Ndërkohë nga ana tjetër, gjyqtarja e çështjes ka vendosur masën "arrest shtëpie", duke mos marrë në konsideratë masën e dënimit që ka vepra penale e kryer prej tre të arrestuarve nga 5 deri në 15 vite burg. Nuk dihet me saktësi se cili ka qënë argumenti që ka përdorur gjyqtarja për lirinë e tre personave të sipërcituar,



Sekuistrohen makina luksoze

por burime pranë prokurorisë thanë se sapo të njihen me vendimin e zbardhur të gjykatës, do e apelojnë atë, duke kërkuar caktimin e masës së "arrestit në burg" për tre personat kryesorë. Ndërkohë sipas të dhënave, kreu i këtij grupi kriminal Bujar Hasa rezultoi të jetë anëtar i Këshillit Bashkiak në Bashkinë e Malësisë së Madhe, ku përfaqëson Partinë e Ballit Kombëtar.

### 12 TË ARRESTUAR ASNJË NË BURG

Gjatë operacionit policor "Lux" policia dhe prokuroria Shkodër arrestuan 11 persona si të dyshuar në trafikimin e automjeteve luksoze. Mirëpo tashmë nga 11 të arrestuarve askush nuk ndodhet në qelitë e burgut, kjo pasi nëntë shtetas janë liruar me kërkesë të vetë prokurorisë, duke caktuar masën e detyrimit për para-

### ANËTAR KËSHILLI

Sipas të dhënave, kreu i këtij grupi kriminal Bujar Hasa rezultoi të jetë anëtar i Këshillit Bashkiak në Bashkinë e Malësisë së Madhe, ku përfaqëson Partinë e Ballit Kombëtar.

qitje dhe tre të tjerë janë liruar nga vetë gjykata. Nëntë nga të arrestuarit e operacioni "Lux" në Shkodër kanë lënë qelitë e paraburgimit, kjo si pasojë e bashkëpunimit me prokurorinë e Shkodrës, duke treguar të dhëna të hollësishme lidhur me veprimtarinë e grupit që vidhte në vendet e Bashkimit Evropian dhe më pas i trafikonte makinat e shtrenjta në Shqipëri, duke përdorur një sërë dokumenta të falsifikuar. Nëntë nga 12 të arrestuarit kanë treguar për prokurorët e çështjes një sërë veprimesh kriminale, të cilat i kryente kreu i këtij grupi Bujar Hasa dhe Tonin Marku e Naim Hasa. Bashkëpunimi me



Bujar Hasa

grupin hetimor ka sjellë dhe zbutjen e masës së sigurisë për 9 të ndaluar. Hetimet për identifikimin e këtij grupi kanë zbuluar se pjesë e këtij rrjeti ka qënë dhe një shtetas tjetër, që rezultoi të ketë vdekur.

### SHEFI I OSHEE NË LAC

Mes personave të arrestuar me urdhër të prokurorisë është dhe shtetasi Lekë Tuna, i cili rezultoi të jetë shefi i agjencisë së OSHEE në Kurbin. Burime pranë prokurorisë së Shkodrës thanë se shefi i agjencisë së OSHEE në Kurbin Lekë Tuna, nuk ka lidhje me anëtarët kryesorë të këtij grupi kriminal. Tuna në këtë rast ka blerë një automjet tek shtetasi Bujar Hasa, dhe se më pas ka rrezultuar se ky automjet është i vjedhur. Nisur nga kjo situatë, gjatë ditës së djeshme mes Tunës dhe Hasës janë bërë ballafaqime, ku Tuna ka treguar me detaje të gjitha veprimet që ka kryer me Bujar Hasën. Ndërkohë lidhur

### LIRIMI NGA QELIA

Pavarësisht provave bindëse që prokuroria e Shkodrës kishte administruar për këtë tre persona, gjyqtarja e Shkodrës Luveta Dade, ka vendosur të lirojë nga qelia tre shtetasit Bujar Hasa, Tonin Markun dhe Naim Hasa.

me arrestimin e Lekë Tunës, ka reaguar për "Shqiptarja.com" dhe babai i zyrtarit të arrestuar, Anton Tuna, i cili ka pohuar se djali i tij nuk ka gisht në vjedhjen e makinave dhe shiten e tyre nëpërmjet dokumentave të falsifikuar. Sipas tij, spektakulli që janë bërë nga partia demokratike janë disformuese dhe është për të ardhur keq, që një parti kaq e madhe bën prononcime të tilla.

## NGJARJA/ EKZEKUTIMI NË JANAR 2016 PAS SHERRIT PËR PRERJEN E PEMËS

# Vrasja për një plep, prokuroria dërgon në gjyq autorin

Prokuroria e Kavajës dërgon për gjykim kërkesën ndaj shtetasit Xhevat Saraçi, i akuzuar për veprën penale të "Vrasjes në rrethana cilësuese" dhe "Armëmbajtje pa leje". I pandehuri akuzohet se ka vrarë me armë zjarri shtetasin Ismet Xhani, si edhe ka tentuar të vrasë shtetasin Marjo Xhani, pas një konflikti për prerjen e një plepi, ngjarje e ndodhur në 4 janar 2016 në fshatin Luz i Madh të Kavajës. Gjatë hetimit, i pandehuri i është nënshtruar edhe ekspertizës psikiatriko-ligjore, nga e cila ka rezultuar se ai nuk vuan nga ndonjë sëmundje e shëndetit mendor. Në datë 4 janar 2016, Komisarjati i Policisë Kavajë është vënë në dijeni në lidhje me një ngjarje kriminale të ndod-



Ismet Xhani

hur në fshatin Luz i Madh Kavajë. Kështu nga kryerja e veprimeve të para hetimore ka rezultuar se është vrarë me armë zjarri shtetasi Ismet (Isuf) Xhani si edhe është tentuar të vritet shtetasi Mar-



Xhevat Saraçi

jo Xhani. Ngjarja ka ndodhur pas një konflikti për motive të dobëta, ku viktima Ismet Xhani dhe shtetasi Mario Xhani kishin prerë një dru plepi i cili sipas autorit Xhevat Saraçi ndodhej në tokën e

tij. Kështu nga tërësia e materialit hetimor të administruar në fashikull rezultoi se viktima Ismet Xhani, kushëriri i tij Marjo Xhani dhe autori Xhevat Saraçi janë bashkëshatar mes tyre, banorinë në të njëjtën lagje, zone, si edhe kanë lidhje farefisnore mes tyre. Ditën e ngjarjes viktima Ismet dhe kushëriri i tij Marjo Xhani kanë shkuar tek tokat e tyre në fshatin Luz i Madh për të prerë dru. Gjatë kohës kur kanë qënë duke prerë drutë aty është afruar shtetasi Xhevat Saraçi dhe i ka kërkuar të mos prisnin drutë apo të i dhidnin në tokën e tij. Sipas shtetasit Mario Xhani konflikti ka ndodhur ekzakhtësisht për një pemë plepi që ndodhej në tokën e babait të tij të cilën autori Xhevat i ka

### DËSHMITARI

Sipas dëshmitarit Mario Xhani vrasja ka ndodhur ekzakhtësisht për një pemë plepi që ndodhej në tokën e babait të tij të cilën autori Xhevat i ka kërkuar të mos e prejnte.

kërkuar të mos e prejnte. Gjatë kësaj kohe është zhvilluar një debat me fjalë mes tyre në lidhje me mosprejen e plepit apo edhe mos hedhjen e druerve në tokën e Xhevat Saraçit. Pas këtij momenti ky i fundit është larguar, ka shkuar në shtëpi, ka marë armën e kriminit dhe ka dalë në rrugën kryesore të lagjes në kohën kur viktima Ismet

dhe shtetasi Mario kanë qënë duke kaluar me karrocën e dorës të ngarkuar me dru. Pikërisht në momentin kur autori Xhevat Saraçi i ka pasur viktimën dhe shtetasin Mario përballë ka qëlluar në drejtim të tyre dhe fillimisht shtetasin Mario Xhani ku ndërkohë viktima Ismet Xhani i është hedhur për ta mbrojtur, por autori ka vazhduar të qëllojë dhe si pasojë viktima Ismet Xhani është goditur në kokë duke gjetur vdekjen dhe shtetasi Mario Xhani ka shpëtuar. Pas kësaj autori ka shkuar në kasollën pranë banesës së tij, ka fshehur armën e kriminit dhe ka dalë në rrugë ku është bërë edhe kapja e tij nga efektivet e policisë sipas edhe procesverbalit të kapjes në flagrancë.

# Vrasja mafioze e Beqirit, policia kap rojen e karburantit

Salla s'tregon asnjë të dhënë mbi 2 vrasësit, prangoset për moskallëzim krimi

**ELTON QVNO**  
TIRANE

Vrasja mafioze e 51-vjeçarit Saimir Beqiri në Elbasan, ka vënë në lëvizje policinë e këtij qyteti, e cila mëngjesin e të mërkurës ka arrestuar një person, jo autor të krimit, por rojen e një karburanti që ndodhet shumë pranë vendit të krimit. Ai quhet Shkëlqim Salla 42-vjeç nga fshati Godolesh, dhe se sipas policisë ai ka dëgjuar zërin e Beqirit që kërkonte ndihmë dhe ka dalë jashtë. Gjithmonë sipas policisë së Elbasanit Salla, ka parë autorët e krimit dhe automjetin e tyre por në polici nuk ka pranuar të flasë. Heshjtje ai ka treguar edhe gjatë momentit kur Shkëlqim Salla është njohur me dhjetëra fotografi të personave të dyshuar që mund të kenë marrë pjesë në vrasje. Nisur nga kjo situatë, policia ka vendosur të ndalojë 42-vjeçarin duke e akuzuar këtë të fundit për veprën penale të "Moskallëzimit të krimit". Pavarësisht veprimeve të policisë, prokuroria e Elbasanit shprehet se në ditët në vijim do vendosë lirinë e Shkëlqim Sallas, pasi vepra penale nuk përbën rrezikshmëri shoqërore.



Saimir Beqiri

Më tej prokurorët thonë se krimi i rëndë është i vështirë të zbardhet, pasi është seri e vrasjeve të përgjakshme që kanë ndodhur kohët e fundit.

**PISTAT HETIMORE**

Vrasja sipas anëtarëve të

grupit hetimor mendohet të ketë ndodhur rreth orës 1:30 të natës, ndërkohë që viktima ka njohur autorin e krimit. Ekzekutimi i 51-vjeçarit është bërë në një distancë të afërt, ku autori pasi është siguruar që kishte vrasë Beqirin është



Vendi ku u vra Saimir Beqiri në Elbasan

larguar nga vendi i ngjarjes duke u ndihmuar nga një person tjetër, që e priste në rrugë me makinë. Lidhur me këtë vrasje policia dhe prokuroria kanë ngritur një grup hetimor, duke u fokusuar në dy drejtime të vetme. Pista e parë ku hetuesit janë përqëndruar ka të bëjë me atë të hakmarjes. Kjo pasi viktima Saimir Beqiri është vëllai i Gentian Beqirit, i vrasë në 2012 brenda në banesën e tij, por në fakt i akuzuar nga prokuroria si njëri nga tre autorët e vrasjes së Sokol Çapjas, në dhjetor të 2005. Hetuesit thonë se konflikti mes fiseve Çapja dhe Mema, nuk kanë të mbaruar, kjo pasi vrasja vjen vetëm 2 muaj pasi masakrës së trëfishit në Elbasan, ku u sulmuar me armë anëtarët e fisit Çapja, teksa qëndronin në një lokal. Në këtë sulm me breshëri automatiku, janë vrarë Agron Çapja, Ardit Sinakoli dhe Eno Bedalli, ndërsa janë plagosur 10 persona të tjerë. Pikërisht këto vrasje, sipas hetuesve mund të jenë bërë shkak në hakmarjen e shpejtë të fisit Çapja, duke vrarë shtetasin Saqimiri Beqiri, i cili si pasijë e kësaj hakmarje ka humbur 4 vite më parë vllain e tij, Gentian Beqirin dhe babain Nezir

## Do lirohet

Pavarësisht veprimeve të policisë, prokuroria e Elbasanit shprehet se në ditët në vijim do vendosë lirinë e Shkëlqim Sallas, pasi vepra penale nuk përbën rrezikshmëri shoqërore.



## Fotografitë

Heshjtje Salla ka treguar edhe gjatë momentit kur Shkëlqim Salla është njohur me dhjetëra fotografi të personave të dyshuar që mund të kenë marrë pjesë në vrasje.



Beqiri. Ndërkohë pista e dytë ku hetuesit janë përqëndruar është ajo e lidhjes së vrasjes

së Beqirit me aktivitetin e tij kriminal, kryesisht në fushën e trafikut të drogës në Itali dhe trafikut të klandestinëve. Disa vite më parë viktima ka patur veprimtari kriminale.

**AUTORËT ME PARUKE**

Vrasja e Saimir Beqirit, ka bërë që policia e Elbasanit të sekuestrojë pamjet filmike të kamerave të disa bizneseve aty pranë, të cilat kanë fiksuar autorët e krimit dhe automjetin me të cilin ata po lëvizin. Burime pranë grupit hetimor thanë se pas verifikimit të pamjeve filmike ka rezultuar se automjeti me të cilin kanë lëvizur autorët është i tipit "Mercedes-Benz Elegance", ndërkohë që autorët mëndohet se kanë qënë të maskuar me paruke. Gjatë ditës së djeshme policia kryevi disa kontrole në dhjetëra banesa duke shoqëruar dhe 15 persona, por askush prej tyre duket se nuk ka dhënë informacione të vleshme për këtë ngjarje. Nisur nga kjo situatë, të gjithë të shoqëruarit janë lënë të lirë, duke bërë që pas 48 orë asnjë person të mos arrestohet për këtë vrasje, përveç rojes së karburantit Shkëlqim Salla për "Moskallëzim krimi".

## LAJME SHKURT

### Mbrojtja e të pandehurve në gjykatë Gjyqi ndaj xhihadistëve, Balla: Po na dënoni se besojmë në Kuran

Ka nisur në Gjykatën e Krimeve të Rënda seanca gjyqësore ndaj xhihadistëve, ndaj të cilëve prokuroria ka kërkuar 152 vite burgim, ku të pandehurit kanë bërë edhe mbrojtjen e fundit. Në seancën e djeshme, e cila është zhvilluar pa praninë e kamerave, të pandehurit janë shprehur se prokuroria kërkon që ti dënojë vetëm se ata besuan në Kuran. Ndërkohë, ata kanë shtuar se, gjithçka që kanë bërë e kanë bazuuar në Kuran. Ata kanë folur edhe sa i takon çështjes së terrorizmit në Siri, luftë për të cilën ata kanë thënë se, ajo po merr jetë të pafajshmish. "Prokuroria do të na dënojë se besojmë në kuran. Ligjeratat e mia i kam bazuuar në kuranin e shpërndarë nga komuniteti musliman. Lufta në Siri është terrorizëm, pasi po vrasin të pafajshmit. Nëse libri i shenjtë kurani që sipas prokurorisë përhap terrorizmin, pse lejohet të shpërndahet?"-ka deklaruar Genci Balla në gjykatë. Ndërkohë Gerti Pashja, pohoi se prokuroria e çështjes kishte servirur prova që s'janë diskutuar asnjëherë në procesin gjyqësor.



Imamët në gjyq

### Rudens Miri u arrestua në Tiranë Në kërkim për tentativë vrasjeje pranga 27-vjeçarit nga Fushë-Kruja

Një i ri i shpallur në kërkim për tentativë vrasjeje dhe armëmbajtje pa leje është arrestuar rreth orës 18:00 të pasdites së djeshme nga policia e Tiranës. Në pranga është vënë 27-vjeçari Rudens Miri, banues në Fushë-Krujë. Ai është shpallur në kërkim më 12 gusht të vitit të shkuar nga Komisaratiati i Policisë Krujë, pasi Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë me vendimin e datës 11 gusht 2015, ka vendosur ndaj 27-vjeçarit masën e sigurisë "arrest me burg" në mungesë, për veprat penale, "vrasje me dashje e mbetur në tentativë" dhe "mbajtje pa leje të armëve e municioneve luftarakë". Pas arrestimit, Miri u shoqërua në Drejtorin Vendore të Policisë Tiranë dhe pritet të tranferohet drej Krujë. Kjo, pasi veprimet për ekzekutimin e urdhërit të prokurorit do të kryen nga specialistët e seksionit për Krimet e Rënda të Komisaratiatit të Policisë Krujë.

FEJA NE SHKOLLA/ KATOLIKET: JEMI 'OK' NE PARIM POR KUJDES

# Lëndët fetare, Katolikët: Kujdes Lindita Nikollën e takuam para 1 muaji

**Ipeshkvi George Frendo intervistë për emisionin "Reze Dielli"**

Kisha Katolike shprehet dakord në parim për lëndët fetare në shkolla por thekson se duhet shumë kujdes me zbatimin e saj. Ipeshkvi i Kishës Katolike Monsinjor George Frendo në

një intervistë për emisionin "Reze Dielli" zbulon faktin se para një muaji e gjysmë janë takuar me Ministrën e Arsimit për këtë çështje me dy kërkesa, mësuesit të jenë të mirë përgatitur dhe tekstet të hartohen të bashkëpunimin me komunitetet fetare. "Para një muaji ose një muaj e gjysmë në kemi zhvilluar një takim me Ministrën e Arsimit. Kjo u prit si diçka pozitive. Por ajo që mbete është se duhet të kemi shumë kujdes për mënyrën sesi do të zhvillohet ky vendim. Unë ende nuk jam në dijeni se çfarë ka thënë Kryeministri, por kam qenë në

takim me ministrën Nikolla ku ishin edhe përfaqësuesit e besimeve të tjera. Duhet të shohim me shumë kujdes se si do të zbatohet", u shpreh ai. Përfshirja e lëndëve fetare në shkollat publike, për Imzot George Frendo nuk e cenon laicitetin e shtetit. Sipas tij, mësimi i fesë do të bëhet nga mësues të përgatitur, ndërsa tekstet do të hartohen në bashkëpunim mes Ministrisë së Arsimit dhe komuniteteve fetare. "Laicitet nuk do të thotë ateizëm. Do të thotë se shteti nuk është i përfshirë në asnjë besim të caktuar. Edhe Papa Piu para shumë

vitesh ka folur për laicitetin e shtetit. Më kujtohet në vitin 2003-ë, kur në Tiranë u organizua një simpozium ndërkombëtare për mësimin e fesë në shkolla. Çdo njeri ka lirinë për të besuar ose jo. Unë kam patur mundësinë të jap një kurs në Shqipëri, për vlerat familjare dhe shoqërore. Besimi është diçka që duhet të ndikojë shumë në jetën e shoqërisë. Sepse besimet janë për bashkim, dashuri, drejtësi, vëllazëri. Vërtetë ndonjëherë besimet kanë qenë të manipuluar dhe ende manipulohen si sot ISIS-i. Kjo nuk është besim,



George Frendo, Ipeshkvi i Kishës Katolike

por një karikaturë besimi. Prandaj, duhet të futet në arsimin shkollos mësimi i fesë. Kemi kërkuar që mësuesit të jetë i përgatitur për të dhënë një lëndë fetare në shkollë. Të

mësojë se çfarë është besimi, cili është roli i besimit, si ndikon besimi në jetën familjare. Kemi kërkuar që tekstet të bëhen në bashkëpunim tonë", theksoi ai. **An.Nd**

SENAD NIKSHIQI  
TIRANE

Komunitetet fetare në Shkodër mbështesin në parim idenë e kryeministrit Edi Rama për të futur në shkollat e Shqipërisë lëndën e fesë por ndahen në disa pjesë të këtij diskutimi. Përfaqësuesi i myftinisë në Shkodër Arben Halluni thotë se këtë myftinia e ka kërkuar shpesh herë dhe është një borxh që shteti shqiptar i ka popullit të vet. "Myftinia Shkodër si pjesë e komunitetit musliman shqiptar e mbështet propozimin, qëndrimin apo deklaratën e kryeministrit Edi Rama të cilat nuk janë një risi përsa i përket futjes së lëndës së fesë në shkolla. Burimin e dinë të gjithë dhe është komuniteti musliman e më kryesisht myftinia Shkodër e cila ka kërkuar vazhdimisht që në shkollat shqiptare të futet lënda e fesë. Mendoj se është një borxh që shteti shqiptar i ka popullit të vet për vendosjen e kësaj lënde në shkolla sepse Shqipëria ka kaluar 50 vite nga privimi i fesë ose lirisë së besimit nga regjimi i egër monist". Futja e lëndës së fesë në shkolla thotë Halluni largon në të ardhmen rrezikun për radikalizmin në Shqipëri. "Turqia por edhe disa vende si Austria, Danimarka apo edhe shtete të tjera kanë të vendosur në shkollat e tyre lëndën fetare, bilës në këto shtete përditësimore është më pak rreziku i ekstremizmit ose radikalizmit dhe lënda fetare në sistemin arsimor shqiptar padyshim që do ndihmojë për të minimizuar këtë fenomen shkatërrues të të gjitha besimeve". Halluni thotë se futja e lëndës së fesë në shkolla nuk cenon aspak laicitetin siç pretendojnë disa. "Nuk e cenon laicitetin futja e lëndës

# Shkoder, muslimanet pro, katolikët: Jemi skeptikë

## Komunitetet fetare në Shkodër mbështesin në parim idenë e Ramës për të futur lëndën e fesë në shkolla



### Myftinia Shkodër

Mendoj se është një borxh që shteti shqiptar i ka popullit të vet për vendosjen e kësaj lënde në shkolla

**NË FOTO:** Përfaqësuesi i myftinisë në Shkodër Arben Halluni dhe Famullitari i Shkodrës dom Artur Jaku

së fesë në shkolla siç edhe pretendohet nga disa opionist ose mendimtar, përkundrazi e forcon laicitetin e shtetit shqiptar sepse i vendoset një themel i ri, themeli i kulturës, pra i besimit. Kjo është e para. Së dyti këtu nuk kemi ndonjë selektim që e cenon kushtetutën apo laicitetin e shtetit".

**KISHA KATOLIKE**  
Kisha Katolike e mbështet parimisht por është skeptike për futjen e lëndës së fesë në shkolla siç deklaroi kryeministri Edi Rama. Në parim kisha e mbështet si ide por ngre disa pikëpyetje që ende nuk


kanë një përgjigje. Famullitari i Shkodrës dom Artur Jaku shpreh këtë skepticizëm që ka kisha katolike për lëndën e fesë në shkolla. "Në parim mësimi për fenë është diçka e mirë që në një farë mënyrë ndihmon dhe edukon breznitë e ardhshme. Ne jemi skeptikë sepse nuk dimë ende se cilat janë mënyrat dhe cilat është arsyeja përse po futet mësimi i fesë në shkolla. Nuk e di nëse do mësohet thjeshtë si histori lënda fetare apo do jetë mësim për fenë. Unë them se nëse do jetë thjeshtë diçka historike do i bëjë mirë natyrisht por nuk e di nëse do jetë thjeshtë informim apo formim. Futja e

lëndës së fesë në shkolla është pikërisht për të luftuar disa sëmundje ndër të edhe terrorizmi dhe radikalizmi. Nëse do jetë thjeshtë një historik i besimeve nuk e di nëse do e ndihmojë realisht breznitë e ardhshme. Të rinjtë tonë kanë nevojë për formim". Dom Artur Jaku shkon edhe më tej teksa thotë se faji në rastet e radikalizmit apo shthurjes shoqërore për kishën katolike nuk është i shtetit por i vetë institucioneve fetare. "Nuk mund të anashkalohej e nuk mund të bie përgjegjësia mbi shtetin por mbi komunitetet fetare për radikalizmin. A ka Shqipëria njerëz kopetent dhe

afër nëse do që t'i formojë siç duhet, goftë në shpirtin e Ungjillit e goftë në shpirtin e Kuranit të rinjtë e ardhshëm. Mësimi mbi besimin mbetet gjithmonë ekskluzive i besimeve fetare dhe këta duhet që ta bëjnë punën dhe të jenë në naltësinë e duhur për ta bërë punën e tyre mësimi". Lënda e fesë në shkolla për kishën katolike nuk e cenon laicitetin në Shqipëri dhe këtu dom Artur Jaku është në të njëjtën linjë edhe me përfaqësuesit e komunitetit musliman. "Besoj që jo sepse feja është element që bashkëjton me njeriun, feja vetëm se e ndihmon personin për rritjen shpirtërore dhe nuk mund të mohohet ana shpirtërore e njeriut por përkundrazi njeriu është edhe trupor por edhe shpirtëror". Futja e lëndës së fesë në shkollat shqiptare ka hapur një debat. Myftinia e mbështet plotësisht të paktën nga deklaratimet e deritanishme ndryshe nga kisha katolike e cila parimisht shpreh dakordsi por ka një skepticizëm nëse do i

PERKRAHJA

**VU: Iniciativa është e duhura, por ja çfarë ne sygjerojmë**




Vëllazëria Ungjillore ka përkrahur iniciativën e qeverisë shqiptare për përfshirjen e edukimit fetar në shkolla, por ka thënë se ajo ka disa sugjerime të cilat mund t'ia bëjë qeverisë për një implementim sa më efektiv. Sipas Vëllazërisë Ungjillore, nxënësit duhet të mesojnë që të analizojnë tiparet e besimeve, duke e parë në kontekstin e jetës së praktikantëve të tyre, përgjithësisht universale për fenë dhe diskutimeve me botëkuptimet e tjera jofetare. Vëllazëria Ungjillore në një deklaratë të shpërndarë për mediat, thekson se, mendimet më specifike do t'i bëjë të ditura më vonë, por parimi i tyre për mbarrëvajtjen e kësaj punë mbetet ai i Jezus Krishtit "bëj për tjetrin atë që do të doje të bëhej për ty".

jepet brezave përmes kësaj lëndë thjeshtë një nocion historik informues apo do të shërbejë për atë që kërkohet ka nevojë, formimin fetar të fëmijëve dhe të rinjve.

# Biznesi gjerman, i pakënaqur nga kushtet për investitorët

## Shqipëria renditet e fundit si destinacion ku gjermanët do të investonin sërish

Shqipëria renditet e fundit si destinacion ku gjermanët do të investonin sërish, si dhe e parafundit në rajon për atraktivitetin si destinacion investimesh. Këto rezultate janë dhënë nga anketimi i kryer nga Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë (DIHA) në 20 vende nga Europa Lindore dhe Juglindore, ku Shqipëria renditet e 19-ta. Të vetmin vend që lëmë pas është Kosova. Gjatë prezantimit nga Dhoma Gjermane, mbi vëzhgimin e kryer në ecurinë ekonomike të vitit 2016 në Shqipëri, u bë e njohur se 56% e bizneseve të anketuara e vlerësojnë situatën negative në 2016. Vihet re një rritje e përqendrimit të situatës pasi vitin e shkuar vetëm 47% e tyre kishin ndjesi negative. Nga ana tjetër, 38% e bizneseve të anketuara e vlerësojnë të kënaqshme situatën në 2016, në krahasim me vitet paraardhëse. Anketimi tregoi, sa i përket të ardhmes, bizneset shprejnë se do të përmirësohet, sidomos brenda sektorit.



Lidhur me situatën aktuale, 5% e të anketuarve e vlerësojnë "mirë" situatën ekonomike, ndërsa vitin e shkuar këtë vlerësim e kishin 19% e bizneseve. Më pozitive vlerësohet situata aktuale e vetë bizneseve, në krahasim me një vit më parë. 28% e bizneseve deklarojnë se situata e tyre është përmirësuar ndërsa vitin e shkuar numri i tyre ishte 23%. Për 54% së të

anketuarve situata ka mbetur e pandryshuar, ndërsa 18% e tyre mendojnë se situata është përqendësuar. Kreu i Dhomës Gjermane

Anette Kasten ka deklaruar se pika kryesore ku ka nevojë për përmirësim situata në vendin tonë është forcimi i shtetit të së drejtës.

Rekomandimet që DIHA ka dhënë për përmirësimin e klimës në vendin tonë janë: Personeli i qëndrueshëm: nevojiten persona kontakti që kanë vite që punojnë në sektor. Sipas vëzhgimeve, në rajon personat e kontaktit nuk ndryshojnë; shkëmbimi në nivel ministror është një pikë shumë e mirë, por duhet që edhe specialistët të kenë zë; shteti i së drejtës dhe taksat: Bizneset gjermane mendojnë se firmat e huaja kontrollohen 20 herë më shumë se vendaset.

## Karburantet

### MEI heq licensën për 40 subjekte të shumicës të hidrokarbureve

Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka miratuar heqjen e licensës për 40 subjekte të tregtimit me shumicë të produkteve hidrokarbure. Vendimi i revokimit është marrë pas inspektimeve të kryera në subjektet sh.a. të cilat rezultojnë se kanë humbur kushtin e kapacitetit depozitues. Në 90 ditë Inspektoriati Shtetëror Teknik e Industrial ka kryer në total 1618 inspektime, duke vendosur 140 gjoba ndaj subjekteve me shkelje. Inspektoriati ka bërë bilancin tremujorit të parë të punës për vitin 2016, nga i cili rezultoi se krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë, për periudhën janar-mars 2016 janë vjelur gjobat në një vlerë monetare prej 25.608.166. Për të njëjtin periudhë të viti të shkuar (janar-mars 2015) janë vjelur 340.102 lekë.



## LISTA E SUBJEKTEVE TË CILAVE U ËSHTË HEQUR LICENSA:

1. "TEA OIL" SHA
2. "EID DIESEL" SHA
3. "ARGOLI" SHA
4. "ENARVIL" SHA
5. "NASEL" SHA
6. "JUKOIL" SHA
7. "AK TRADE INTERNACIONAL OIL"
8. "ITAL LUBRIKANT" SHA
9. "RIRA" SHA
10. "VILOIL" SHA
11. "TEA CONSTRUCTION & PETROL" SHA
12. "RUÇI PETROL" SHA
13. "I & A INDUSTRI" SHA
14. "OXFORD ALBANIA" SHA
15. "COBIAL" SHA
16. "LM - OIL" SHA
17. "JAMB" SHA
18. "EUROPROGRES" SHA
19. "BROKA OIL" SHA
20. "MARE OIL" SHA
21. "TEA CONSTRUCTION & PETROL" SHA
22. "BACOGAS- ALBANIA" SHA
23. "SPRING OIL" SHA
24. "2A&F" SHA
25. "EXIMOIL" SHA
26. "ALBANIA MOTOR COMPANY" SHA
27. "ALB TEC OIL" - SHA
28. "ANOIL" SHA
29. "PETROLIMPEX" SHA
30. "SIAL" SHA
31. "TEA COSTRUCTION & PETROL" SHA
32. "ALBATRAS-OIL" SHA
33. "AUTO MASTER" SHA
34. "ACI ENGINERING" SHA
35. "ALBANIAN INTER OIL 10" SHA
36. "SHIGJETARI-B" SHA
37. "K.E.L" SHA
38. "BUNKER ALBANIA" SHA
39. "YLLI PETROL" SHA
40. "R.B.H. BELINE" SHA

## INTERESI / AMBASADORJA KINEZE, TAKIM ME AIDA DHE TREGTARE KINEZE

### AIDA rikonfirmon ndihmën për sipërmarrjet kineze



Dje, në ambientet e AIDA-s, u zhvillua takimi ndërmjet përfaqësuesve të AIDA-s dhe një delegacioni kinez të kryesuar nga ambasadorja kineze në Tiranë Znj. Jiang YU, dhe funksionarë të tjerë tregtarë të ambasadës. Qëllimi i këtij takimi ishte konkretizimi i bashkëpunimit në drejtim të investimeve kineze në Shqipëri dhe mundësitë konkrete që Shqipëria ofron në këtë drejtim. AIDA, në zbatim të misionit të saj, konfirmoi dhe një herë ndihmën për sipërmarrjet kineze në Shqipëri dhe asistencën për të gjitha ato që synojnë tregun shqiptar për të investuar në fushat strategjike


si, infrastrukturë, bujqësi, turizëm, energji dhe zonat ekonomike. Prezantimin rreth mundësive që ofron Shqipëria për investime në këto fusha u krye nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë, Genti Beqiri, i cili në emër të institucionit shprehu gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse kineze, në drejtim të zhvillimit të investimeve dhe intensifikimit të marrëdhënieve tregtare mes dy vendeve. Kina është e pranishme në Shqipëri me shumë projekte. Projekti më i fundit është blerja e aksioneve të kompanisë Bankers nga kompani kineze, interesi për Aeroportin

e Rinasit por edhe për aktivitetet në fusha të tjera me rendësi. Sipas të dhënave të fundit statistikore, Kina pozicionohet si partneri i dytë tregtar i Shqipërisë. Shkëmbimi tregtar me Kinën ka arritur pesë të konsiderueshme duke zënë rreth 7.1% të totalit të shkëmbimeve tregtare në muajin shkurt 2016. Mesazhi që përcolli ky takim nënvizoi edhe njëherë faktin që Shqipëria shihet si një partneri rëndësishëm ekonomik në rajon, dhe se ajo mund të shërbejë për të gjitha sipërmarrjet kineze për t'u zgjeruar jo vetëm brenda territorit, por në gjithë rajonin e Ballkanit dhe me gjerë.

## VLERËSIMI / NË 2017-N RITJA PRITET TË PËRSHPËJTOHET NË 3.8%

### FMN: Shqipëria me rritje ekonomike 3.4% më 2016

Fondi Monetar Ndërkombëtar në rishikimin e prillit të ecurisë ekonomike globale e ka mbajtur të pandryshuar parashikimin për rritjen ekonomike të Shqipërisë për vitin 2016 në 3.4%. Në 2017-n rritja pritët të përshpejtohet në 3.8%. Nga shtetet e rajonit, për vitin 2016 rritjen më të lartë pritët ta ketë Mali i Zi me 4.7%, i ndjekur nga Maqedonia me 3.6%, më pas vijnë Shqipëria dhe Kosova me nga 3.4% dhe Bosnja me 3%. Serbia pritët të



vijojë më zgjerimin më të ulët, prej 1.8%. Sipas tabelave të raportit, për 2015-n rritja për Shqipërinë pritët 2.6%, nga 2.7% që ishte në parashikimin e teorit dhe në linjë me publikimin e fundit të INSTAT për një zgjerim prej 2.62%. Edhe në afatin e gjatë, rritja e Shqipërisë pritët të jetë e ngadaltë, duke u ulur lehtë parashikimi nga 4.2% në 4.1% (periudha 2020-2021). I gjithë rajoni në fakt pritët të zgjerohet edhe në afatin e gjatë me 3-4%, duke shënuar kështu

një normalitet të ri, me rritje shumë më të ulët se 8-10% që u panë përpara vitit 2008. Për Shqipërinë, inflacioni pritët të vijojë i ulët, nën 3% për periudhën 2016-2017, përkatësisht me 2.2% dhe 2.7%, duke qenë poshtë objektivit të shënjestruar prej 3% të Bankës së Shqipërisë. Shqipëria dhe Mali i Zi kanë bilancin e llogarisë korente më të lartën në rajon, përkatësisht me -12.7% dhe -16.5% të prodhimit të brendshëm bruto.

# QË BALTRAT TË MOS MBULOHEN ME BALTË



NGA ILIR DHIMA

**K**ur dramaturgu i famshëm Pierre Corneille dikur thoshte që koha është pasuria e vetme për të cilën mund të tregohemi kopracë pa u turpëruar, shumëkush e ka përsëritur dhe vërtetuar përmbytjen e kësaj thënieje me përparimet e shpejta dhe në vazhdimësi, që i tërhoqën shumë vende dhe popuj e tyre drejt civilizimit modern. Ndërsa të tjerë, siç është vlerësuar dhe vlerësohet sot pa mëdyshje, mbeten mbrapa ngaqë janë tepër dorëlëshuar me kohën, duke e shpërdoruar atë edhe në çaste vendimtare, kur e lënë atë t'u rrëshqasë me lehtësi të pamatshme, si rëra mes gishtërinjve. Arsytet e kësaj prapambetjeje janë të shumta, por më shpesh gishtit drejtohet te ato klasa politike, të cilat i stopojnë zhvillimet nëpërmjet zënkave të pambarimta mes tyre, që tejkalojnë jo vetëm etikën njerëzore, por edhe të gjithë treguesit e konkurrencës së lirë.

Një shembull shprehës është Shqipëria, ose gjithçka ka ndodhur në skenën politike të saj gjatë 25 vjetëve të fundit tek ende nuk është kapërcyer plotësisht hendeku i Tranzicionit. Dhe, kur pikërisht tani që erdhi momenti për të zgjidhur hapat drejt ndryshimeve të thella, veçanërisht me reformën në sistemin e drejtësisë dhe me atë zgjedhore, thesi i sherreve duket sikur nuk do të zbrazet kurrë.

Tani gjithçka po ndodh nga një forcë politike, si Partia Demokratike dhe liderët e saj, për t'u hakmarrë ndaj kundërshtarëve të tyre më të suksesshëm, që brenda tre viteve të mbrame fituan dy herë rresht votat e popullit, duke e lënë tashmë opozitën në dyshimin e një prognoze për humbjen e vet të tretë dhe të thellë në zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Pasaiojat e kësaj prognoze, liderët dhe eksponentët të tjerë opozitarë ka ca kohë që i përkthejnë në vetëvete me fletë-arreste ndaj tyre, me vendime gjyqësore penale, me sakuëstrime pasurish të grabitura dhe me çdo ndëshkueshmëri tjetër që mund të bazohet legjitimisht të ato veprime dhe mosveprime të tyre, kur mbanin pushtetin dhunshëm mbi kokat e shqiptarëve.

\*\*\*

Kështu pra, si të gjithë shpirtrat e zbrazët, ata priren tani drejt opiniononeve ekstreme, duke vërvitur sidomos përpara Projektit-Kushtetues për ndryshime në sistemin e drejtësisë depozita balte për të mbuluar baltrat e tyre, që reforma e këtij sistemi një ditë në mos dështoftë, së paku të devijojë.

Pas zgjidhjes së një ngërçi të lidhur fort prej tyre për varësinë e Byrosë Kombëtare të Hetimit, Kryetari i opozitës, ndryshe nga ç'kishte thënë më parë dhe nga çfarë deklaroi gjatë vizitës së fundit të tij në SHBA, theksin e rradhës e vuri te disa kushte të reja. Pra, jo vetëm te dërgimi në Gjykatën Kushtetuese të çështjes së dy mandateve të tjera të deputetëve të Partisë Socialiste, por edhe te ndryshimet në ligjin për komisionet hetimore. Nëse mazhoranca po jepte

shënja për plotësimin e kushtit të parë, të dytin nuk mund ta pranonte. Nuk mund ta pranonte pretendimin e opozitës se, në komisionet hetimore (prej kohësh është dakorduar se mund të ngrihen edhe me kërkesë të opozitës, ndonëse deri tani të gjitha ato të iniciuara dhe kryesiuara prej saj kanë dështuar) duhet të vendosë opozita edhe pa pjesëmarrjen e mazhorancës, kur vihet në pikëpyetje vetë konfigurimi i Kuvendit, si edhe parashikimi i Kushtetutit, se Ky organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve (neni 75/2). Në vazhdim të këtij kushti të papërmbyshur, eksponentët të opozitës u përpoqën të formulonin një tjetër kërkesë të kësaj natyre dhe ta tundin atë dje në Kuvend si një mollë shërri: ngritjen e një komisioni hetimor për marrëveshjen e Qeverisë me CEZ.

Këto ditë, përpjekjet e ethshme të pakicës për të gjetur dhe vendosur kushte të reja nuk kanë të sosur. Në një kohë kur ka filluar punën Komisioni i Posaçëm për reformën zgjedhore, lideri i Partisë Demokratike shpalli si të domosdoshmë aplikimin e sistemit elektronik në zhvillimin e zgjedhjeve parlamentare të ardhshme, çka nuk mund të bëhet jo vetëm për shkak të mungesës së theksuar të një infrastrukturës së duhur, qoftë edhe për projekte pilot në këtë drejtim, por edhe sepse nga përvoja e afërt, madje edhe nga koha kur qeveriste opozita e sotme, pra, edhe gjatë zgjedhjeve të vitit 2013, i mundur është bërë vetëm dështimi i aplikimeve të tilla. Ndërkohë që ka ende shtete – anëtare të Bashkimit Evropian, si Lituania, që para tre vjetësh u mor këtu nga ish kryeministri Berisha shembull për t'u kopjuar, në zgjedhjet e fundit atje i zhvilloi votimin dhe numërimin e votave në mënyrë elektronike veçse në 17 për qind të zonave elektorale. Ndërkohë që duke parë me sy hapur ëndrën për rotacion politik sa më të shpejtë, opozita po bën tani gati për zgjedhjet e 2017-s një listë garancish dhe kushtesh të pazakonta, si për ndryshimin e sistemit zgjedhor të parashikuar në Kushtetutë, dhe të tjera në tejkallim të rekomandimeve të OSBE/ODIHR.

Por absurditeti i këtyre kërkesave lë përshpytje të hidhur te faktori ndërkombëtar, veçanërisht se ato ngrihen në vijimësi, periodikisht, kur pritet pa vonesë mirëkuptimi apo konsensusi midis mazhorancës dhe opozitës, për të miratuar sefte Projektin-Kushtetues të ndryshimeve në sistemin e drejtësisë, për çka tashmë e ka thënë edhe fjalën e fundit Komisioni i Venecias me Opinionin e vet final.

Kjo pabesi e opozitës, që përgjerohej se do të miratonte pa hezitim gjithçka do të rekomandonte ky organ këshillimor i Këshillit të Evropës dhe i parapëlqyer nga Bashkimi Evropian në pikëtimin e rrugës së integritimit të Shteteve aspirante dhe kandidatë, si Shqipëria, nisi të kuptohej që në fillim të

**Çdo shtetas dhe aq më shumë deputetët (apo ata që qëndrojnë pas tyre) duhet ta dinë se asnjë ligj nuk mund të kundërshtojë dispozitat kushtetuese; se asnjë ligj i thjeshtë, ose edhe i përforcuar, nuk mund të jetë ekuivalent me përcaktimet që bën Ligji Themelor i Shtetit**



këtij viti. Pikërisht atëhere, kur nuk kishin kaluar vetëm pak javë nga miratimi konsensual, me votim të cilësuar i ligjit të iniciuar dhe të paraqitur për votim nga opozita, me nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", objekt i të cilit është, gjithashtu, "...mbrojtja dhe garantimi i mirëfunksionimit demokratik të Kuvendit, organeve të qeverisjes vendore...". Për të mos u konsideruar e mbyllur "periudha përgatitore" e miratimit të gjithë reformës në drejtësi, nga e cila varet shumë çelja e bisedimeve për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nga opozita u hodhën ca vicka, që u pasuan me vënie e shumë vçklave, si sebepe për të sabotuar gjithë reformën. Konkretisht, u paraqitën disa shtesa të këtij ligji, të cilat mazhoranca me të drejtë nuk i miratoi, duke nuhatur dhe deklaruar se, po t'i jepej opozitës gishti, ajo do t'i kërkonte dorën, dhe nëse do t'i ofrohej edhe kjo, ajo do t'i merrte tërë krahun.

Por...në të vërtetë, më parë mazhoranca ia kishte shtrirë dorën opozitës, për t'u arritur konsensusi i mirëpritur për nisjen pa zvarritje të reformës në drejtësi. Kjo ndodhi, sepse miratimi i ligjit 138/2015 do të kërkonte fillimisht ndërhyrjet në Kushtetutë, për t'u kufizuar disa të drejta themelore si, për shembull, ajo e ushtrimit të votës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Këtë qëllim i shërbeu formulimi dhe miratimi i ligjit kushtetues nr. 137/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar. Pavarësisht motivit të drejtë që e shtyu mazhorancën të apronte me nxitim këto ndryshime dhe shtesa, pasojat po vuhën edhe sot, për të mos thënë edhe nesër. Pra, le t'i hedhim një vështrim qoftë edhe tangencialisht këtij ligji. →

● Faksimile e Kushtetuta e Shqipërisë



Dihet se çfarë shkruhet pa përpjekje, në përgjithësi lexohet pa kënaqësi. Për të mos folur pastaj, se edhe "gërvishtjet" e bëra tinëzishit nuk mund të kenë jetë të gjatë. Dhe këtë e tregon fare qartë teksti i ligjit nr. 137/2015, i cili përmban vetëm 5 nene. I pari, që i shtohet si paragrafi 1 nenit 6 të Kushtetutës parashikon: "Ndalohej zgjedhja, emërimi apo ushtrimi i një funksioni publik në një nga organet e parashikuara në këtë Kushtetutë, ose të krijuara me ligj, pavarësisht përcaktimeve të bëra në dispozitat e tjera të kësaj Kushtetute, nëse verifikohen rrethana që cenojnë integritetin e funksionarit publik, sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit". Si kështu? Një ligj, qoftë ky i miratuar me votim të cilësuar, na paska përparësi ndaj parashikimeve të bëra nga çdo dispozitë tjetër e Kushtetutës?! Çdo shtetas dhe aq më shumë deputetët (apo ata që qëndrojnë pas tyre) duhet ta dinë se asnjë ligj nuk mund të kundërshtojë dispozitat kushtetuese; se asnjë ligj i thjeshtë, ose edhe i përforuçar, nuk mund të jetë ekuivalent me përcaktimet që bën Ligji Themelor i Shtetit.

Më tej, në të dytin nen të këtyre amendimeve, që ndryshojnë nenin 45, paragrafi 3, të tekstit original të Kushtetutës parashikohet: "Përjashtohet nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në raste përjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t'u zgjedhur para dhënies së një vendimi përfundimtar apo kur shtetasit janë dënuar për një krim ose për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike". Sigurisht, në raste të veçanta dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë edhe kufizime të së drejtës për të zgjedhur, por jo para dhënies së një vendimi përfundimtar. Sepse kjo bie ndesh me nenin 30 të Kushtetutës në fuqi, sipas të cilit: "Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë". Gjithashtu, sipas nenit 17 të Kushtetutës, i cili mbetet në fuqi parashikohet që kufizimet të tilla "... nuk mund të cenojnë thelbin e lirisë dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut". Madje, sipas nenit 151/2 të Ligjit Themelor, disa çështje, midis të cilave edhe kufizimi i lirisë dhe i të drejtave themelore të njeriut, s'mund të shtrohen në asnjë referendum.

Për të mos u zgjatur me përjashtimin nga prezumimi i pafajësisë vetëm për krime të përcaktuara në Statutin e Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare, ndoshta është e nevojshme të theksojmë se, parimet kushtetuese të përfshira në Kushtetutë nuk janë shprehje voluntarizmi e disa individëve, politikanëve apo e një grupi ligjëvënësish të veçantë. Para së gjithash, ato konsiderohen si deklarata të vullnetit për të qenë pjesë e civilizimit juridik. Detyra e tyre normative ka atë nocion dhe vlerë, pa të cilat nuk mund të kuptohen dhe të rregullohen në mënyrë objektive e të përgjithshme faktet e jetës individuale dhe kolektive. Prandaj, nuk ka dhe nuk mund të ketë hierarki midis këtyre parimeve. Pra, nuk ekziston ndonjë parim udhëzues që të jetë superior në krahasim me të tjerët, përveçse atij që parime të tilla duhet të bashkëqëndrojnë dhe të bashkëveprojnë.

E domosdoshme është që ligjëvëni/t nuk duhet të harroj/n/ë për asnjë çast, se cenimet që u bëhen (si këto me ligjin nr. 137/2015) disa të drejtave universale dhe kombëtare të shtetasve krijojnë tensione juridike, politike, ekonomike dhe sociale, rrezikun e të cilave e kanë vënë në dukje edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë (vendimet nr. 36/2007; nr. 25/2009 etj.) dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila ka nënvizuar veçanërisht rëndësinë e garancive "reale dhe efektive" për individët.

\*\*\*

Në këto kushte, kur mbi bazën e shtojcave të bërë Kushtetutës me ligjin nr. 137/2015 opozita do të vazhdojë gërr-mërrret, për të mbuluar baltrat e saj, ende mbetet një rrugë për t'ia hequr efektin ligjit të mësipërm, e cila të çon te Gjykata Kushtetuese. Pra, që së paku një grup deputetësh të mazhorancës t'i drejtohen asaj me kërkuesën jo për shfuqizimin, por për interpretimin e dispozitave të atij ligji. Për një mundësi të tillë mbase mjafton të shfletojmë tekstin e Opinioneve paraprak për reformën në drejtësi të Komisionit të Venecias, në faqen 9 të përkthimit në shqip të të cilit lexojmë: "Në çdo rast Gjykata Kushtetuese, kur zbaton ndryshimet e miratuara tashmë do të duhet të konsiderojë tekstin kushtetues në tërësi dhe të interpretojë ndryshimet nisur nga parimet e përgjithshme kushtetuese të përcaktuara në të drejtën themelore të Shqipërisë".



## FOTOLAJM

### Varreza e shqiptarëve në malësinë e Malit të Zi, që po mahnit botën

Varrezat e Vuksanlekajve në Malësi të Malit të Zi cilësohen si monumente të një rëndësie të veçantë jo vetëm në Mal të Zi por edhe në rajon. Ata janë varreza pa emra dhe vetëm me simbole të gdhendura në gurë dhe që konsiderohen si të vetmet në hapësirën e Ballkanit, raporton VoA. Specialistët të kësaj fushe vlerësojnë se këto varreza duhet të studiohen, të identifkohen dhe të mbrohen si një trashëgimi e veçantë materiale në zonën e Malësisë. Varreza ka tërhequr vëmendjen e studiuesve nga disa vende të botës.



## J KANCER

Eduko, parandalo!

vijon nga numri i djeshëm

ENEIDA XHELILI  
TIRANE

**P**ërshëndetje, miqtë e mi! Sot gjendemi në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", konkretisht në Spitalin Onkologjik, qendra e vetme kombëtare ku të sëmurët drejtohen kur kanë problematika tumorale. Konkretisht ne jemi pjesë e vazhdimësisë së fushatës në luftën kundër kancerit të gjirit, por jo vetëm. Por sot do të përqendrohemi te kanceri i gjirit, në fakt, dhe kemi ardhur të bisedojmë me një mjek, i cili ka shumë përvojë dhe është pjesë e hallkës së radiologjisë në zinxhirin e gjatë të trajtimit të kancerit. Jemi këtu pranë me dr. Adrian Hotin.

**Bëmë mirë që e sqaruar këtë sepe jo gjithmonë është informacioni i duhur. Megjithatë në periudhën që ju jeni pjesë intensive e të sëmurëve me kancer gjiri ka pozitivitate, ka ndryshime, ka përmirësime? Mund të japim ndonjë notë pozitive për sa i përket kësaj problematike, përveç hallëve që përmendëm dhe ku duhet të synojmë?**

Atëherë, sa më mirë të jemi aq më shumë do të kërkojmë si nga qeveria ashtu edhe nga burimet e tjera. Pra, informacionet që vijnë gjithmonë na e shtojnë kërkesën. Dhe në qoftë se ne themi një mbijetesë e pacientit me kancer në tërësi, do të thotë një mbijetesë me kosto. Ky pacient është gjithmonë nën ndjekjen e organeve shëndetësore dhe herë pas here kërkon trajtime me medikamente apo kirurgjikale dhe të gjitha këto kthehen pastaj në shpenzime financiare. Ne gjithmonë, çdo hap që do të hedhim, do ta bëjmë vetëm duke u mbështetur, duke bërë kërkesa financiare. Tani po i kthehem pyetjeve që më bëre. Thashë që para disa vitesh, në vitin 2007, ishte një program – Interakt 3, i cili solli në Shqipëri 4 mamografi digjitale, të cilat u instaluan në 4 qytete kryesore. Sigurisht që kjo ishte një risi për shëndetin publik shqiptar. Më vonë, në 2010-ën, u blenë edhe disa të tjera, të cilat u instaluan në qytetet e tjera. Edhe ky ishte një akumulim për të kryer ekzaminimet mamografike. Kjo ka sjellë edhe përfitim përvojë, edhe sensibilizim të popullatës, por ajo që unë konstatoj është që numri i ekzaminimeve që kryhen në këto mamografi është akoma i pakët. Kjo për arsye se qëshjet burokratike ndoshta, me të cilat ne kemi organizuar sistemin shëndetësor që të funksionojë, edhe i vështirësojnë situatat. Unë them që në shërbimin parësor problemet duhet të jenë më të thjeshta. Ndryshe është që të bësh një vizitë në Qendrën Universitare Terciare, ndryshe është që të kesh një shërbim shëndetësor më afër popullatës, i cili është parësori dhe këtu përsëri ka vështirësi për të realizuar një ekzaminim mamografie. E them këtë sepse nuk e quaj të



**NË FOTO:**  
Adrian Hoti, mjek radiolog  
në Qendrën Spitalore  
Universitare "Nënë Tereza"

# Shërbimi i onkologjisë në QSUT "Nënë Tereza" me ngarkesë të madhe

## Metoda diagnostikuese më e fiksë kundër kancerit të gjirit është mamografia

### KANCERI

Jo vetëm ne si mjekë në Shqipëri, por edhe bota njeh atë kancer që quhet kanceri i intervalit, që do të thotë se gruaja ka bërë një mamografi para 2 vjetësh dhe pa priturr momentin për të bërë një mamografi tjetër pas 2 vjetësh, asaj i shfaqet një masë.

vlerësuar, në qoftë se një mamografi e instaluar në Durrës, Shkodër apo edhe këtu te ne, të kryejë vetëm 5-6 mamografi në ditë. Këto shërbime, sidomos me situatën që kemi në këtu në Shqipëri, duhet të funksionojnë paradite dhe pasdite, të ndara në dy turne, me planifikimet e duhura. Planifikimet duhen bërë duke llogaritur mirë kohën për ta bërë kontrollin më efikas. Pra, e gjitha kjo që të funksionojnë më shumë mamografitë. Por, ne jemi më mirë se ç'kemi qenë. Kjo as që diskutohet, por, gjithsesi, nevojat vijnë duke u shtuar.

**Mund t'ju bëjë një pyetje që ndoshta, për shumë shikues, mund të duket naive, por do të kisha dëshirë që të sqaronim se ku hyn**

**mjeku radiolog. Besoj që nuk hyn vetëm te mamografia, apo jo, në pjesën trajtuese, parandaluese, në ndjekje dhe në gjithë tjetër që ka të bëjë me tumorin e gjirit.**

Realisht, radiologjia si specialitet, është mjaft e lidhur me problemet e patologjive hapësirëzënëse, që shihen, që preken, që ndodhen brenda trupit dhe që realizimi i pamjes së tyre arrihet vetëm me mjetet imazherike. Fusha e veprimit të radiologut është nga ajo evidencuese, diagnostikuese dhe terapeutike. Jo sot, por ka shumë vite që është zhvilluar dega e radiologjisë intervencionuese, ku me anë të rrugëve shumë pak dëmtuese, ajo arrin që të bëjë terapi lokale, të marrë biopsi, pra, pa shkakuar dëm të mëdha, të marrë biopsi në organet e brendshme. Po kështu, me anë të rrugëve që ajo zotëron arrin që të fusë edhe medikamente lokale, pra, është edhe terapeutike. Prandaj quhet radiologjia intervencionuese dhe, sidomos në onkologji ka dhënë rezultate mjaft pozitive. Në vendin tonë akoma nuk e kemi zhvilluar këtë lloj radiologjie për arsye të infrastrukturës që kemi, të përvojës së kufizuar dhe të koston së madhe financiare që ka si shërbim.

**Arrin numri i mjekëve radiologjicë të jetë ai i duhuri për të përballoar nevojat e pacientëve shqiptarë, në qoftë se flasin për realitetin tonë, aktualisht?**

Atëherë, unë mendoj që numri i

### RADIOLOGE

Breza të tërë po dalin si radiologë dhe sigurisht që atyre nuk u duhet kërkuar që në ditën e parë të punës një shërbim i tillë. Edhe unë kam pasur shumë dëshira para disa vitesh, që disa janë realizuar e disa jo dhe kjo, jo nga mosdëshira ime por nga mosgjatja e terrenit

radiologëve arrin sepse, në qoftë se vijnë te faktori njeri, faktori njerëzor është më shpejt i arritshëm. Faktori njerëzor nuk mungon në Shqipëri, sidomos po flas për fushën time, në radiologji. Breza të tërë po dalin si radiologë dhe sigurisht që atyre nuk u duhet kërkuar që në ditën e parë të punës një shërbim i tillë. Ato shkojnë paralele. Edhe unë kam pasur shumë dëshira para disa vitesh, që disa janë realizuar e disa jo dhe kjo, jo nga mosdëshira ime por nga mosgjatja e terrenit për të aplikuar ato që unë kisha mësuar në një vend të caktuar.

**Doktor, jam kurioze të di se si paraqiten në ditët e sotme gratë pranë mjekut?**

Në realitet, vijnë në stade të

ndryshme. Kemi gra dhe vajza që paraqiten te mjeku edhe me shenjë në subjektive për dhimbjen e gjirit, pa pasur asnjë shenjë tjetër klinike, por, fatkeqësisht kemi edhe raste mjaft të avancuara. Problemi i gjirit është problem sa i thjeshtë në dukje, por aq i ndërlikuar në natyrën e tij, për arsye se, jo vetëm ne si mjekë në Shqipëri, por edhe bota njeh atë kancer që quhet kanceri i intervalit, që do të thotë se gruaja ka bërë një mamografi para 2 vjetësh dhe pa priturr momentin për të bërë një mamografi tjetër pas 2 vjetësh, asaj i shfaqet një masë. Dhe kjo përbën rreth 20-30% të rasteve të reja në të gjithë botën. Pra, do të thotë që kanceri i gjirit është aq kameleon sa, megjithëse ti e ke vizituar përpara 2 vjetësh, ai prapë të shfaq një masë. Ka forma të tilla të rritjes, të formimit të asaj që i thonë lamb. Por gjithsesi, në Shqipëri, rastet vijnë akoma të avancuara. Kjo do të thotë që ato e kanë humbur shansin në momentin e parë për të bërë një kirurgji dhe jemi të debytur që t'i cojmë në kimioterapi. Sigurisht kjo tregon edhe për nivelin që kemi ende si shoqëri. Por ka edhe raste që, megjithëse kanë kryer vizita, përsëri ato kanë atë fat që të ndodhen përpara të papriturës.

**Mund të shmanget kjo, duke iu referuar rastit të parë që ka gra që kontrollohen dhe përpara se të vijë periodikisht periudha e vizitës, ato kanë një shfaqje të tumorit apo të një mase?**

Me fjalën kancer ne kemi të bëjmë me natyrën e jetës, natyrën e biologjisë. Edhe me të gjitha këto përpjekje nuk është se ne do ta luftojmë kancerin, por ne do të ulim vdekshmërinë e kancerit. Kjo ndodh jo vetëm te ne, por edhe në Amerikë, Kanada e kudo. Thjesht ulim vdekshmërinë nga kanceri që të kemi sa më shumë të mbijetuar. Por ajo është pjesë e biologjisë sonë dhe nuk e shmangim dot. Do ta kemi përherë armik tonin dhe nuk besoj se do të arrijmë që të jemi gjithmonë fitimtarë, por që të ulësh 30% vdekshmërinë e kancerit është një rritje e madhe. Ne nuk jemi aty. Rastet e reja që vijnë, të cilat janë në fazë të hershme, janë te 10-15%. Prandaj na duhet që të gjithë këto që folëm më sipër ta organizojmë mirë, në qoftë se arrijmë të kemi një fazë skrining, atëherë ne do të arrijmë në shifrën 30%.

**Një mesazh për gratë që na ndodh sot?**

Sigurisht mesazhi im është që ato të mos harrojnë që duhet të vizitojnë gjirin, duke filluar nga mosha 40-45 vjeç, të frekuentojnë kabinetet e mamografive sepse kështu do të ulin rrezikun për të mbartur një patologji kaq të rëndë siç është kanceri i gjirit. Sigurisht, me këtë nuk është se eliminohet çdo lloj kanceri. Është vetëm kanceri i gjirit, i cili, është një kancer që po të kapet në fazat e hershme trajtohet, dhe lejon që të gruaja të bëjë një jetë normale për të dhe për familjen e saj. Sigurisht, që shëndeti është ai që mundëson që ne të gëzojmë një jetë të shëndetshme dhe të lumtur.

# Bruksel-Kosovë, pritet liberalizimi i vizave

## Vojislav Sheshel anuloi vizitën në Kosovë, pasi ishte paralajmëruar se mund të arrestohej

**K**omisioni Europian pritet të rishikojë deri në fund të muajit gëshjen e heqjes së vizave edhe për Kosovën, duke shqyrtuar nëse vendi i ka plotësuar kushtet e parashtruara nga Brukseli për të përfituar nga udhëtimi lirshëm brenda zonës "Schengen". Një zyrtar i Bashkimit Europian dha lajmin për Kosovën, por edhe për udhëtimin pa viza për ukrainasit, pavarësisht rezulttit të referendumit holandez për marrëveshjen BE-Ukrainë.

Kosova është i vetmi vend në Ballkan, që nuk e ka fituar ende të drejtën e lëvizjes pa viza në hapësirën "Schengen", edhe pse për disa vite me radhë, autoritetet kosovare kanë punuar në bashkëpunim me institucionet e BE-së për të plotësuar të gjitha kushtet e kërkuara për procesin e heqjes së vizave.

Udhëheqësit e BE-së kanë premtuar përpjekjet e liberalizimit të vizave për Turqinë, me qëllim arritjen e një marrëveshjeje deri në fund të qershorit, në qoftë se



Komisioni Europian

Ankaraja do t'i ketë plotësuar kushtet e vendosura nga marrëveshja me BE-në. Por propozimet e Këshillit Europian duhet të miratohen me shumicë të cilësuar të vendeve anëtare të BE-së, si dhe nga Parlamenti Europian për të hyrë në fuqi.

### SHESHSEL

Vojislav Sheshel ka anuluar gjatë ditës së djeshme vizitën në Kosovë, pasi Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës kishte paralajmëruar se ai mund të arrestohej nëse futej në territorin e Kosovës. Ndryshe nga sa kishte paralajmëruar partia e tij, Sheshel teksa ka folur për hapjen e fushatës, ai i ka përshëndetur radikalët serbë të Kosovës përmes një lidhjeje telefonike. Përmes


kësaj lidhje, mediat kosovare thonë se, ai ka deklaruar se ka pasur në plan të udhëtojë për në Mitrovicë, por nuk e kanë lënë regjimi i Prishtinës dhe ai i Beogradit.

Përveç kësaj, mediat kosovare bëjnë të ditur se, ai ka akuzuar deputetët e Listës Serbe në Kosovë duke thënë se ata kanë bërë të mundur që me votat e tyre të bëjnë Hashim Thaçin president i Kosovës.

Për vizitën e tij të paralajmëruar, autoritetet kishin deklaruar më parë se ai do të arrestohej. "Ministria e Punëve të Jashtme nuk e ka lejuar vizitën e tij, tash i takon organeve të rendit të veprojë kundër kontrabandimit dhe kalimeve ilegale të njerëzve", ka thënë Selimi për mediat kosovare.

### ANKETA

## Mbështetja e të rinjve për ISIS-in është në rënie



Mbështetja e rinisë arabe për ISIS-in ka rënë ndjeshëm. Në këtë përfundim ka mbërritur një anketë e "Arab Youth Survey". Sipas anketës, pjesa më e madhe e të rinjve në Lindjen e Mesme nuk mbështetnin organizatën terroriste dhe besojnë se ajo do të dështojë në ngritjen e një kalifati. Vetëm 13 për qind e të pyeturve thonë se e imagjinojnë veten në mbështetje të ISIS-it nëse ai nuk do të përdorte këtë valë dhune, nga 19 që ishin vitin e kaluar. 50 për qind mendojnë që problemi më i madh i rajonit është pikërisht ISIS-i, nga 37 për qind që mendonin kështu një vit më parë. Megjithatë, mungesa e vendeve të punës dhe e programeve për të angazhuar rininë rrezikon që kjo përkrahje për ISIS-in të qëndrojë në këto shifra, citohet "Arab Youth Survey". Ky ishte viti i jetë i son-dazhit, që synon të japë një pasqyrë të aspiratave të 200 milionë banorëve të rajonit. Këtë vit, vetëm 36 për qind mendojnë se bota arabe është më mirë se më parë, nga 72 për qind që ishte në vitin 2012. Pjesa më e madhe e të rinjve të pyetur vlerësojnë në këtë moment stabilitetin më të rëndësishëm se demokracia, ndërsa në 2012, 93 për qind e të anketuarve kishin ëndërr më të madhe demokracinë.


## TERRORIZMI/ NË SHUMICËN NE RASTEVE, JANË VAJZA TË DROGUARA

# Boko Haram përdor gjithnjë e më shumë fëmijë-kamikaze

**A**q shumë e ka shtuar Boko Haram përdorimin e fëmijëve-kamikazë, sa vitin e fundit, një në 5 sulme vetëvrasëse të grupit islamik llogaritet të jetë kryer nga një i mitur. Pas 3/4-tës së sulmeve në fjalë qëndrojnë vajza, të cilat shpeshherë drogohen prej militantëve të Boko Haramit në Kamerun, Nigeri e Çad. Në këto vende, si dhe në Niger - thotë UNICEF, - numri i fëmijëve të marrë forcërisht nga shtëpitë e tyre është 1.3 milionë. Të dhënat publikohen në përvjetorin e dytë të rrëmbimit të mbi 200 vajzave në qytetin nigerian të Chibokut. Për Manuel Fontaine, drejtori rajonal i UNICEF-it në Afrikën Perëndimore e Qendrore, të miturit e përdorur në sulme kamikaze nuk duhen parë si luftëtarë të vullnetshëm.

"Për të qenë sa më të qartë, në fillim dua të them se këta fëmijë janë vik-tima, jo autorë krimesh. Mashtrimi i të miturve apo detyrimi i tyre me forcë për të kryer akte vdekjeprurëse është një prej aspekteve më të tmerrshme të dhunës në Nigeri dhe vendet fqinje me të", tha Manuel Fontaine, UNICEF. Përdorimi i fëmijëve nga Boko Haram, nga sa pohon Fontaine më tej, ka gjithmonë e më shumë një efekt shoqëror korroziv në këto zona, ku komunitetet kanë nisur t'i shohin si kërcënimin e t'i përjashtojnë të abuzuarit nga radhët e tyre. Reagimi ndërkombëtar ndaj emergjencës në rajon ka qenë tepër i ngadaltë dhe, këtë vit, agjencia e OKB-së për fëmijët nuk ka mbledhur veçse 11% të shumës së nevojitur për financimin e përgjigjes së saj humani-

tare në Nigeri, Niger, Kamerun dhe Çad. Bëhet fjalë për një 11-fishim të sulmeve, nga 4 që ishin në vitin 2014, në 44 në vitin pasardhës. Ndryshimi i taktikës, sipas ekspertëve, reflekton humbjen e territorit në Nigeri nga Boko Haram. Rebelimi 7-vjeçar, që ka prekur kryesisht verilindjen e Nigerisë, por edhe fqinjët e saj, ka lënë rreth 17 mijë persona të vdekur. Rrëmbimi i tyre shkaktoi një fushatë globale me thirrjen "Na ktheni vajzat tona", por deri tani asnjë prej tyre nuk është gjetur. Raporti thotë se, djemtë detyrohen nga militantët të sulmojnë familjen e tyre për të treguar besnikërinë ndaj Boko Haram, ndërsa vajzat bëhen prë e abuzimeve seksuale dhe detyrohen të martohen me luftëtarët.



Boko Haram

## LAJME SHKURT

### Kohë të vështira për presidenten e Brazilit



Dilma Rousseff

Presidentes së Brazilit, qëndrimi në pushtet po i bëhet gjithmonë e më i vështirë. Vota e komisionit 65-anëtarësh të Kongresit veniti shpresat e saj për të shmangur procedurat e hetimit, mes pretendimeve se ka manipuluar të dhënat qeveritare, me qëllim fshehjen e deficitit të lartë buxhetor. Të gjithë sytë do të kthehen tani te votimi i plotë në Dhomën e Ulët të Parlamentit, i parashikuar të mbahet më 17 ose 18 prill. Kjo çështje e ka përçarë thellë vendin, e policia po përparon për protesta masive në kryeqytetin Brazilia. Votimi në komision erdhi mes skenave kaotike të krijuara mes mbështetësve dhe kundërshtarëve të Rousseffit, që përsërisnin slogane e shpalosnin pankarta. Edhe pse ky votim në vetvete është përgjithësisht simbolik, ai u pa si test për mbështetjen ndaj procesit hetimor përpara votës së plotë në Dhomën e Ulët. Një shumicë prej dy të tretash nevojitet atje, që çështja të përfundojë në Senat dhe sondazhi më i fundit, i publikuar nga e përditshmja "Estadão" tregon se, 292 nga 513 anëtarët janë në favor të hetimit, 115 janë kundër dhe 106 janë të pavendosur. Senati në parim e ka fuqinë ta pezullojë Presidenten, ta çojë në gjyq e në fund edhe ta shkarkojë nga detyra. Popullariteti i Rousseffit ka rënë ndjeshëm muajt e fundit, i goditur rëndë prej rënies ekonomike dhe skandalit dëmtues të korrupsionit, që rrethon gjigantin shtetëror të naftës, "Petrobras".



### BE: Kompanitë të tregojnë se ku i fshihin paratë

Komisioni Europian pritet të bëjë publike planet e tij që i detyrojnë kompanitë e mëdha të shtojnë transparencën për taksat. Rregullat e reja do të prekin firma shumëkombëshe më me fitime nga shtjitet që shkojnë në mbi 750 milionë euro. Atyre do t'i duhet të tregojnë me detaje sa taksa paguanjnë në secilin vend të BE-së, si dhe të japin hollësi mbi çdo aktivitet të ndërmarrë në parajsat e caktuara fiskale. Planet e KE-së vijnë në mesin e një shtimi të ndjeshëm të kontrolleve mbi përdorimin e parajsave tatimore, pas shpërthimit të afërës së Panama Papers. Aktualisht, ekzistojnë një sërë rregullash raportimi që aplikohen mbi bankat, industrinë e minierave dhe kompanitë pyjore. Por sipas propozimeve të reja, ato do të zgjerohen duke përfshirë kompani që 90% të të ardhurave të korporatave, i nxjerrin në Bashkimin Europian.

# “Marubi”, për herë të parë në Berlin, ekspozohen 35 fotografi

Ekspozitë me foto të ralla, e para në llojin e saj në kryeqytetin gjerman

Për herë të parë në Berlin do të çelët ekspozita “Marubi”, ku do të ekspozohen 35 fotograf me vlera historike. Ekspozita organizohet me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës së Republikës dhe departamenti Kulturor i Ambasadës Shqiptare në Gjermani. Kjo ekspozitë realizohet në kuadër të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin kulturor. Kjo ekspozitë, e para në llojin e saj në kryeqytetin gjerman, në të cilën parashikohet të ekspozohen 35 fotografi me vlera historike, so-

cialë kulturore dhe antropologjike, gjithashtu edhe foto të pazakonta me mesazhe të një natyre shkencore ose simbolike, do të tregojë fytyrën evropiane të Shqipërisë e cila ka qenë kulturisht dhe intelektualisht e lidhur me Evropën ndër shekuj. Objektivi i saj është të dëshmojë këtë fakt dhe gjithashtu të rregullojë imazhin stereotip të krijuar për shqiptarët në Gjermani lidhur me fluksin e tanishëm të refugjatëve. Italiani Pietro Marubbi u largua nga vendi i tij për arsye politike. Ai erdhi së bashku me pajisjet e tija fotografike dhe u vendos në veri të Shqipërisë duke ndërthurur kështu një perandori fotografike, e cila është një thesar i

për Shqipërinë, 500000 imazhe të Shqipërisë së vjetër janë shkrepur në disa dekada. Pa këto dokumente historike, vështirë se do të dinim sot sesi dukej Shqipëria në periudhën gjatë viteve 1858-1940. Fotografi Pietro Marubbi ka bashkëpunuar me dy shqiptarë të rinj e të talentuar që e vazhduan punën edhe pas vdekjes së tij: Kel dhe Gegë Marubi të cilët arkivuan në studio, mbi tre breza të Shqipërisë, në shekullin e 19-të dhe të 20-të. Këto ishin foto e para në qytetin verior shqiptar të Shkodrës. Sot ajo studio fotografike është një muze që përmban një koleksion prej gjysmë milion fotosh. Më 14 tetor 2015 mori jetë duke u publikuar online për pub-




likun, Muzeu Virtual Marubi, i cili përfshin rreth 100 000 fotografi të shkrepura gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX-të dhe fillimit të shekullit XX-të. Ky projekt konsistoi në arkivimin, katalogimin dhe dixhitalizimin e arkivës fotografike të Fototekës Kombëtare Marubit, dhe krijimin e një faqe ësh për promovimin dhe prezantimin për vizitorët të cilët dëshirojnë për të zbuluar

më shumë rreth identitetit kulturor dhe historisë së Shqipërisë, përmes përfshirjes në një udhëtim vizual të fotografive online. Deri më tani, projekti ka arritur të dixhitalizojë në rezolucion të lartë pjesën më të vjetër të arkivit, koleksionin e Dinastisë Marubi me rreth 100.000 fotografi, ndërkohë që procesi i arkivimit dhe katalogimi dixhital vazhdon...

ANASTAS KONSTADINI

## “Piktura moderne e nevojshme për të shprehur paqartësinë e artistit”



Rreth 40 punime të reja në vaj të piktorit Anastas Konstadini janë ekspozuar në Galerinë FAB në Universitetin e Arteve. Pikturat variojnë në formate të mëdha. Ekspozita e Konstandinit që njihet nga të gjithë me emrin e artistit Taso titullohet “Pasqyra e thyer”. Kjo ekspozitë është kapitulli i tretë i një cikli mbi jetën në provincë. Vetë piktori Taso ka preferuar që krijimtarinë e tij ta zhvillojë në provincë, në qytetin e vogël të Pogradecit. “Kjo i përket ciklit, pjesës së tretë të një cikli pikturash. Të gjitha këto piktura përbëjnë një cikël rreth vendlindjes time. Përmes një mënyrë indirekte të të parit të gjërave. Ky është një qytet që është vetja ime, familja ime, që unë e shikoj në mënyrë indirekte përmes një pasqyre që është një dobësim i imi fizik dhe më ndalon të jem pjesë e plotë e atij realiteti” ka thënë autori. Ekspozitë e Tasos do të qëndrojë deri më 20 prill e çelur në

Galerinë FAB. Kjo ekspozitë sjell një këndvështrim të krisjes së objektit, ku Taso reflekton në telajo botën përrëth. Piktori krijon trille shumë tërheqëse dhe të vlerësuara nga artadashësit dhe kritika. “Nuk ka vlerësim më të madh sesa të vijnë gjithë këta miq këtu, kaq artëdashës, është një vlerësim për veprat e mia, kanë histori me pikturat e mia, kanë këmbyer veprat e artistëve të tjerë që më mbajnë nëpër shtëpitë e tyre. Unë ndjehem i shpërblyer, pastaj sa shteti merret me ne mua s’më intereson, por duhet ti interesojë shteti për të parë sesa shteti interesohet për shtetasit e vet” ka përfunduar ai. Të gjitha objektet e përdorura në pikturat e Anastas Konstandinit krijojnë një lojë që kalon nëpërmjet filtrave gjeometrikë por që është gjithësi e lexueshme nga publiku. Metaforat pikturike të Tasos zakonisht janë të lexueshme nga publiku.



EUROSONG

## Tarifa pas intervistës: S’ka asgjë të keqe të pyesësh për një fjalë

Eneida Tarifa, këngëtarja e zgjedhur për të prezantuar Shqipërinë në Eurovision, ka reaguar pas intervistës së dhënë për një televizion holandez, ku ajo paraqet vështirësi me të folurën e saj, në gjuhën angleze. Tarifa shprehet se para asaj interviste kishte dhënë edhe 20 tjera, dhe se nuk “nuk ka asgjë të keqe të pyesësh për një fjalë që nuk po të kujtohet për momentin në gjuhë të huaj”. “Si fillim dua t’ju them se gazetari dhe drejtuesit e tij na kërkuan falje për transmetimin e

intervistës pa e edituar. Mund të ishte edhe qëllimshme, nuk e di, por nuk ka asgjë të keqe të pyesësh për një fjalë që nuk po të kujtohet për momentin në gjuhë të huaj, sidomos nëse ke dhënë 20 intervista të tjera para asaj, të gjitha në anglisht. Isha aq e lodhur sa për një moment m’u kujtua filmi “Edhe kuajt nuk vdesin kështu”, por ju nuk keni nga ta dini këtë. Më habit fakti që mediat po mbushen me lajme “DNSH”-je se janë të varfër në informacion dhe mezi presin të gjejnë diçka

për t’u kapur, kur fare thjesht mund të shihnin edhe intervistat e tjera që kam dhënë. Por edhe nëse unë nuk di anglisht, gjë që nuk është e vërtetë, nuk ka asgjë të keqe sepse jo të gjithë këngëtarët e Eurovizionit dinë të flasin rrjedhshëm anglisht ose edhe nuk dinë fare”, thotë Tarifa për Blitz. Eneida Tarifa e ka mbyllur deklaratën e saj duke theksuar se nuk do të ndikohet nga vogëlsira të tilla pasi qëllimi kryesor është përfaqësimi sa më dinjitoz i Shqipërisë në Eurovision.





Provat për "Messa di Gloria" në TKOB




TKOB/Vepra e Puccinit ngjitet në skenë më 14 prill

# "Messa di Gloria" për herë të parë në Tiranë

*Ermal Pepa: Bëra masterclass me Ermonela Jahon, rikthehem pas 5 vjetëve nga grupi i Vedat Ademit*

**DHURATA HAMZAI**  
TIRANE

**M**essa di Gloria", vepra që Puccini e kompozoi, kur ishte vetëm 18 vjeç, do ngjitet për herë të parë në skenën e Teatrit të Operës dhe Baletit në Tiranë. E konsideruar si vepra që i paraparapriu genialitetit të Puccinit, Mesha do ngjitet në skenë më 14 prill. Kjo vepër kërkon zëra të zgjedhur, punë me korin, duetet dhe orkestrën, të cilën po e drejton dirigjenti Olsi Qinami, që e zhvillon karrierën e tij në Angli. "Janë shumë zëra që e bëjnë të vështirë interpretimin e kësaj vepre, por edhe të mrekullueshme. Kërkohej kujdes me materialet solistike e korale, kori ishte shumë potent, dhe me meloditë e mrekullueshme me synimin që të japin atmosferën e asaj muzike që e dallon Puccinin nga të tjerët", dha dirigjenti Olsi Qinami. Olsi Qinami është dirigjent/pianist që jeton në Londër gjithashtu është dhe themelues. Ai ka punuar dirigjent dhe Drejtor Artistik i "London Thames Orchestra", ndërsa si shoqërues piano, Olsi ka punuar me shumë ansamble, instrumentistë dhe këngëtarë në koncerte dhe audicione. Pjesa më e madhe e materialit muzikor të "Messa di Gloria" është e shkruar për një kor prej katër zërash. Kori dirigjohet nga Dritan Lumshi. Ai shfaqet në disa plane muzikore, në të cilat shpeshherë hasim në kontraste



Tenori Ermal Pepa

dinamikash nga piano e deri tek fortissimo, sipas Lumshit. Një nga numrat më të gjatë të veprës, "Gloria" vjen si një e tërë në disa materiale, me plane tonale të ndryshme. "Përveç mjeshtërisë së shkrimit muzikor, ajo çka unë do ta quaja

## PREMIERA

"MESSA DI GLORIA" NGA  
GIACOMO PUCCINI

- Interpretojnë:
- Kori dhe Orkestra Simfonike e TKOB
- Solistë: Enricho Marchesini (bas), Armando Likaj (bariton), Ermal Pepa (tenor)
- Dirigjent kori : Dritan Lumshi
- Dirigjent: Olsi Qinami

## PROGRAMI:

- I. Kyrie
- II. Gloria
- III. Credo
- IV. Sanctus e Benedictus
- V. Agnus Dei



Dirigjenti Olsi Qinami

si sfida e interpretimit të kësaj vepre, është fuga, e cila kërkon një impenjim profesional mjaft të lartë. Tek "Credo", unisonet e shpesh të krijojnë idenë e një tingëllimi universal e gjithëpërfshirës. Ajo që të bie në sy është fakti se sa i

pranishëm është kori gjatë gjithë kohës. Në numrin e fundit, Puccini e ka kaluar në plan shoqërues për t'i lënë hapësirë duetit të tenorit dhe baritonit. Kjo të krijon ndjesinë e një vepre të papërfunduar", rrëfën dirigjenti i korit Dritan Lumshi.

Artistët pjesëmarrës si tenori Ermal Pepa, solisti italian bas-Enricho Marchesini dhe baritonit Armando Likaj shprehën se kjo vepër kërkon një impenjim profesional mjaft të lartë.

Jo më kot, tenori Ermal Pepa, pianist në grupin muzikor Vedat Ademi & The Band është rikthyer pas 5 vjetësh pauzë në opera.

"Më duket si ëndërr që më ftuan të këndoj vepërën e Puccinit. Falënderoj dirigjentin e korit Dritanin se ideja ishte e tij. Më pas unë mora pjesë në masterclass-et që zhvilloi Ermonela Jahon dhe fitova audicionin për këtë vepër të mrekullueshme. Unë kam mbaruar shkollën për kanto, por punoj si pianist në

grupin e Vedat Ademit. Kam qenë 5 vjet në pauzë si kwiqwtar, dhe tani kthehem me këtë vepër të mrekullueshme", rrëfën tenori Pepa, i cili gjatë provave është vlerësuar shumë nga kolegët dhe dirigjenti Olsi Qinami.

"Messa di Gloria" nis me violinat, të cilat vijnë si një lutje e brendshme që përcillet nga solistët e zgjedhur. Gjatë provave ndoqëm trajtimet e bukura korale të dirigjuara nga Dritan Lumshi, të cilat gërshetoheshin me materialet solistike dhe muzikën e mrekullueshme të Puccinit interpretuar nga Orkestra e Teatrit të Operës dhe Baletit.



Provat për "Messa di Gloria" në TKOB

# 'De Biasi do të jetë pasuesi i Conte-s tek Italia'

## Trajneri i kombëtares shqiptare është më i preferuari i presidentit Tavecchio pas Fabio Capello-s

**G**ianni De Biasi tashmë është një nga kandidatë kryesorë për të marrë drejtimin e kombëtares së Italisë. Lajmi është bërë i ditur nga mediat italiane sipas të cilave trajneri i kombëtares italiane është një nga emrat më të fortë si kandidatura për të zëvendësuar Antonio Conte-n. Sipas sportmediaset presidenti i Federatës Italiane të Futbollit Tavecchio ka zhvilluar më 7 mars një takim paraprak me De Biasi-n, gjatë ceremonisë së çmimeve për trajnerët italianë. Që atëherë ka pasur komunikime telefonike midis trajnerit dhe presidentit të federatës, por edhe me Claudio Lotiton që veç president i Lacio-s është edhe zv/president i federatës. Gjithashtu De Biasi ka kontakte të shpeshta me Pasquale Gravina, president i Lega Pro (federata për klubet e kategorive amatore) i cili është edhe promovuesi më i madh i tij për t'i besuar pankinën "axurre". Sipas medias italiane takimi i fundit midis drejtuesve të federatës italiane dhe trajnerit ka qenë para tre ditësh. Por, edhe pse De Biasi është një nga kandidaturat më të forta, ende nuk mund të flitet për një marrëveshje, pasi presidenti Tavecchio ka si objektivi



**NË FOTO**  
Gianni De Biasi

parësor një emër shumë më të madh. Fabio Capello është emri i parë për Tavecchio-n, i cili ka planifikuar edhe një takim të fundit me ish-trajnerin e Rosisë. Në fakt pak kohë më parë Capello ka deklaruar se nuk i intereson "timoni" i Italisë, por ai ende nuk ka thënë një përgjigje përfundimtare negative. Veç Capello-s një emër tjetër i fortë është ai i trajnerit aktual të Torinos, Gianpiero Ventura. Me një eksperiencë të gjatë në kampionatin italian Ventura ka edhe dëshirë për këtë post, diçka të tillë e deklaroi edhe të hënën në emisionin sportive të Italia

1 "Tiki-Taka". Gjithsesi, De Biasi është i avantazhuar falë suksesit të madh që ka me kombëtaren e Shqipërisë dhe ky është një plus i madh për të. Kujtojmë se De Biasi ka rinovuar kontratën me Federatën Shqiptare të Futbollit për të drejtuar kuqezi deri në 2017-ën, por në rast se e thërret Italia vështirë se FSHF mund ta pengojë. Nëse marrëveshja finalizohet me federatën italiane, atëherë Shqipëria do ta ketë përballë De Biasin si kundërshtar për eliminatoret e Botërorit 2018, pasi kuqezi janë në të njëjtin grup me Italinë.

### Shkurt **Seria A Allegri, te Juventusit deri në vitin 2018**

— Rinovimi i kontratës së Massimiliano Allegri me Juventusit është më pranë se kurrë. Sipas "Tutto Sport", zyrtarizimi i marrëveshjes së re do të vijë javën e ardhshme. Në këtë mënyrë trajneri nga Livorno do të ketë mundësi të vijojë me projektin e nisur në verë të 2014, me kontratë në re që do të jetë e vlefshme deri në vitin 2018, që do të thotë se kontrata aktuale është shtyrë me një vit. Allegri, pas largimit të Conte-s gjeti një skuadër me mentalitet fituesi, por merita e tij është se jo vetëm e fitoi titullin kampion, por arriti deri në finale të Championsit, ku u mposht nga Barcelona. Në sezonin e dytë Allegri hasi më shumë vështirësi, pasi i është dashur të rindërtojë skuadrën pas disa largimeve të rëndësishme. Falë mbështetjes së skuadërës ishte në gjendje të ngjitej në vendin e parë pas një starti të dobët të Serisë A. Allegri nuk u josh nga propozimet për të marrë drejtimin e kombëtares italiane, por edhe të skuadrave angleze dhe spanjolle, të cilat i ka refuzuar të gjitha për të qëndruar te Juventusit.



### **Champions League Përbysje e Realit, City për herë të parë në gjysmëfinale**

— Reali i Madridit dhe Man.City janë dy skuadrat e para gjysmëfinaliste të Champions League. Madriënë përbysën humbjen 0-2 të ndeshjes së parë ndaj Wolfsburg duke fituar 3-0 në sfidën e kthimit me Cristiano Ronaldo-n që ishte protagonist i madh i takimit me 3 gola, që e konfirmojnë dhe si kryegolashënues të këtij kompeticioni me 16 finalizime. Goli i parë ishte i thjeshtë për portugezin që shtyu topin në rrjetë, ndërsa në të dytin goditi saktë me kokë pas goditje këndi. Ndërsa goli i kualifikimit ishte i tëri i tiji duke i dhënë dhe përbysjen që në kohën e rregullt Realit Man.City për herë të parë arriti gjysmëfinalen e Champions pasi mundi 1-0 në ndeshjen e kthimit PSG, pas barazimit 2-2 në Paris dhe arriti të kalojë më tej. Në pjesën e parë Agueiro humbi një 11-metërs, ndërsa në të 76-tën De Bruyne shënoi golin e fitores. PSG pa t'i anulohet një gol me Zlatan Ibrahimovic në minutën e 85-të për pozicion jashtë loje. Për parizienët ky ishte sezoni i katërt radhazi që elimohet në çerekfinale.

### Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

#### LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- Humbja e ministritë, çamët nisin lëvizjen për Polin e Tretë
- Strasburgu hap '21 Janarin' sekuestrim dosjes hetimore
- Një shqiptar humbet jetën në Dubai, u hodh me parashutë
- KL.SH alarm në Kuvend: Dëmi ekonomik 1 miliard euro
- Suedi -Ju prezantoi me John, babain me leje linqe
- Basha përjashton ministrat e Berishës nga turi për programin
- Pas '21 janarit' Ndrea Prendi sërish fiton palajesi në gjyq
- Armina dhe Shkëzëri, ja ku 'calon' puna tek dashuria e tyre
- Veliaj: Nishani, i vetmi me vilë në park e eskortë në pedonale
- Pagesa për babet e lindura,përfitojnë vetëm të lindurit pas 1 Janarit 2016

#### LAJMET MË TË KOMENTUARA

- Humbja e ministritë, çamët nisin lëvizjen për Polin e Tretë
- Strasburgu hap '21 Janarin' sekuestrim dosjes hetimore
- Veliaj: Nishani, i vetmi me vilë në park e eskortë në pedonale
- KL.SH alarm në Kuvend: Dëmi ekonomik 1 miliard euro
- Hafizi: Do tu tregojmë socialistëve si u manipulua referendumi i 9 Prillit

#### VIDEOT MË TË KLIKUARA DJE

**Ersekë, 2 vëllezër barinj qëllohen me armë: Jemi në rrezik për jetën**

**Onkologjiku i përgjigjet Vokshit: Aparaturat në punë, sot 80 analiza**


**Rruga "Pavarësia" përplas Bashkinë Durrës e PD-në, çështja në Prokurori**

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

### SONDAZHI | DITES

A mendoni se Gjykata e Strazburgut do i japë drejtësi çështjes së 21 janarit??

#### Rezultati i Sondazhit



#### SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampionëve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



1,629 | 276,300  
KOMENTET E DJESHME | TOTALI LIKE

FJALËKRYQESH

NGA Kadri VOKOPOLA



FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 35 KUTI

12x17 grid for word search puzzle.

HORIZONTAL

- 1. Interpretua nga Albert Verria.
-Një thirrje parandaluese.
-Kush e thotë... pyet.
2. Janë drejtëzat që nuk takohen kurrë.
-Fillojnë panikun.
-Një cigan
3. Janë njerëzit pa shtetësi.
-Ishin ushtarët e Akilit.
4. Janë grykëset.
-Këndohet nga Norma.
5. Kalohet me gjumë.
-Freskon nga tavani.
6. Gjysmë totale
-Jan zyza në komo.
-Kufizojnë dënimet.
7. Mbyllin koncertin.
-Ngihen me doli.
-Kështu fillon filmi
8. Mund të jetë një sulm.
-Emri i Anceolitit.
9. Kishin mbret Bardthyllin.
-Një që thur ode
10. Une dhe ti.
-Tregu pa kufij.
-Pak aperitiv.
-Eshhtë i shtatë ai i kinemasë
11. Janë vendet si Katar
-Ndizen me një çelës.
12. Janë katër ato të violës.
-Forza... e Berlusconi-t
-Eshhtë baba.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

Grid with words filled in for the word search puzzle.

VERTIKAL

- 1. Në të del ai që bie në sy.
-Ishin gjigantë si Hiperioni.
2. Një fletore në kazermë.
-Demë s'ka kufij.
3. Janë kundërmuese
-Initialet e Dunaway.
-Illion Lika.
4. Janë në gjyq.
-I ka të ndryshme Siria.
-Fillojnë raportin.
5. Këndon Together.
-Janë maskarënj, të poshtër.
6. Nevil, ish-futbollist.
-Janë gjëra.
7. Gjysmë aleate.
-Një veshje e epokës që preferohet
8. Unë dhe ti.
-Marcel që që kampion i boksit
9. Janë pelerinat.
-Kufizojnë datat
10. I ndjekin detektivët.
-Reid aktore.
11. Janë deshëmorrë të kishës.
-Pak pilografi.

- 12. Kanë shpatë
-... në bronz në një film.
13. Janë sprova.
-Dy asa.
14. Gjysmë ditari.
-Mbyllin stihise.
15. Kështu qeheshin beatnikët në Holandë.
-Bëjnë katror me një kat.
16. Një zbulues nëndetësesh.
-Janë me dy faqe
17. Demek pa ekstreme.
-U shkurra nga Dostojevski

FJALËKRYQI SPORTIV

Grid for sports-themed crossword puzzle.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

Grid with sports-related words filled in.

HORIZONTAL

- 2. Ushtrohet me pressing.
8. Vëlliu i paharruar i mikrofonit sportiv
10. Dalë më krye.
11. Me out në parquet.
13. Bëhen me trehapësh në kosh.
15. Initialet e Lendl.
16. Loni motokiklist
17. Fund ditari.
18. Mbyllin një sirtar.
20. Shtëpia e... Ferrari-t
21. Pak servilizëm.
22. Betim pa kufij.
24. Grirë pa kufij.
25. Një Ford që bën... mu.

- 26. Lauda i automobilizmit.
29. Një sporti basketesh.
32. Të parat në bllok.
34. Ai dhe ajo.
36. Personazhi në foto.
43. Gjysmë trofeu.
46. Personazhi në foto.
47. Pak iniciativë.
VERTIKAL
1. Një koshi i shënuar pas kthimit nga tabela.
2. Carlo, që që treneri Juventus.
3. Thomas Alva i shpijkejur.
4. Kotherja i arbitrave dikur.
5. Numri letë i Italisë.
6. Fillojnë nisjen
7. Eshhtë heroi pozitiv.
8. Një i mbrojtës është për të mbrojtur.
9. Bo aktore.
12. Eshhtë guajtja... personale.
13. Argento regjisor.
14. Tesla pa zanore
16. Lewis Biri i eres.
18. Skuasër greke.
19. Mbyllin një raport.
23. Të fundit në princip
27. Initialet për dy Bergman.
28. Në krye të klasifikimit.
30. Emri i Cantona.
31. Të parat në stafetë
33. Tre Asa.
34. Aty në kufij
35. Eshhtë baba.
36. Initialet e Malkovich
37. Maurice Ravel.
Diftong në teori.
39. Fillojnë vrapin.
40. Kufizojnë ambiente.
41. Fillojnë rubrikën.
42. Donna Summer.
44. Kufizojnë rajonin.
45. Fund heroi

SUDOKU

PLOTESONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGA 1-9

Sudoku grid with some numbers filled in.

Another Sudoku grid with some numbers filled in.

HOROSKOPI

DASHI

Për ata që janë tashme në një lidhje sot do jetë një ditë tërësisht ndryshe nga me parë. Ata do i shprehin me tepër ndjenjat dhe harmonia do rikthehet. Beqaret as që do mëndonin dy here para se të pranojnë një ftesë që do ju behet. Shume gjera kanë për të ndryshuar njëherë e përgjithmonë. Për financat nuk do përkujdeseni aspak dhe situata ka rrezik t'u përkeqësohet të mase.

DEMI

Te martuar apo thjesht te dashuruar, marrëdhënia në çift ka për të qene e jashtëzakonshme sot. Shfrytëzoheni çdo sekonde sikur te ishte e fundit. Beqaret do bëjnë mire te mos ndërmarrin shume rrezike vetëm për ta ndryshuar statusin sepse situata me vone mund t'iu dale jashtë kontrollit. Financat do mbeten ende delikate dhe mezi do arrihen te kryeni shpenzimet e nevojshme.

BINJAKËT

Jeta në çift nuk ka për te shkuar aspak mire sot. Here pas here mund te kenë edhe debate te ashpër te cilat mund te çojnë ne ndarje me shpejtë nga sa mendoniit. Mos u tregoni krenare dhe kujdes edhe me xhelozinë. Beqaret duhet te rikthehen sa me pare ne realitet pasi ne te kundërt do vuajnë. Gjendja e financave do jetë përgjithësisht e mire fale mbështetjes se madhe te Plutonit.

GAFORRJA

Jeta juaj ne çift do jete harmonike, e ekuilibruar dhe çdo gjë ka për te ecur si duhet. Vazhdoni t'i shprehni parëndësishit ndjenjat dhe shfrytëzoheni çdo moment emocionues. Fale pozicionimit te mire te Venusit ne qiellin e dashurisë se beqareve, sot do jete një ditë fantastike për ta. Ne planin financiar ka rrezik te përballeni me probleme, për shkak te shpenzimeve te konsiderueshme qe keni kryer.

LUANI

Dita e sotme nuk ka për te qene aspak ashtu si ju e keni ëndërruar. Bashkëpunimi dhe mirëkuptimi i kohëve te fundit do zëvendësohen ne debate te forta. Beqaret nuk do e kenë gjithë kohës mendjen tek dashuria, por Venusi do krijojë mundësi interesante për takime. Buxheti nuk do mund te përmirësohet edhe sikur ju te bëni përpjekjet me te mëdha. Kënaqni qe situata te jete e qëndrueshme.

VRGJËRESHA

Tensioni do shuhet përfundimisht sot nga jeta juaj ne çift dhe do njiheni me te qete se kohet e fundit. Do jeni me te hapur dhe do i pranoni gabimet qe keni bere vete. Beqaret do kenë fat ne dashuri dhe si pa e kuptuar do fillojnë një lidhje fantastike. Ja qe ndonjëherë gjërat me te bukura ndodhin papritur. Ne planin financiar fati do ju buzëqeshë. Mund te kryeni edhe investimet e mendoara.

PESHORJA

Nuk do jeni shume te kënaqur sot nga sjellja e partnerit dhe do flisni hapur me te për këtë gjë. Edhe pse mund te mërziteni është me mire te flisni tani qe është herët për këto gjëra. Beqaret do enden sa anëj këndëj për serish nuk kane për ta gjetur dashuri. Financat nuk do jene ne gjendjen e menduar kështu qe nëse nuk doni probleme kujdes me çdo shpenzim.

AKREPI

Mos u mundoni gjate gjithë kohës ta kontrolloni partnerin tuaj sot sepse ai do mërzitet dhe situata mund t'iu dale jashtë kontrollit. Beqaret nuk do realizonë ndonjë takim mbresëlënësh dhe me shume gjase nuk do arrijnë dot ta ndryshojnë statusin e tyre. Saturni ka për te ndikuar keq tek financat. Ai do ju nxitë te jeni te palogjikshëm dhe do shpenzoni pa fund.

SHIGJETARI

Beni te pamundurën qe te mos ju përfshijë rutina sot ju te dashuruarit sepse me pas do keni probleme vërtet serioze. Shtojni dozaz e imagjinatës. Beqaret ka rrezik te pranoni diçka propozimë nga te cilat do zgjidhen e do lindohen. Për financat ka për te qene një ditë e keqe kështu qe mundohuni te shpenzoni me kursin sa me shume qe te mundeni.

BRICJAPI

Pasioni do rikthehet fuqishëm ne jetën tuaj ne çift sot. Pas një periudhe delikate, sot do ripërjetoni emocionet dhe kënaqësitë e hershme pranë partnerit. Beqaret duhet t'i shfrytëzojnë mundësitë qe do iu jepen për takime, por ne asnjë mënyrë nuk duhet te marrin vendime te rritura. Situata financiare ka për te qene shume delikate dhe nuk do arrihen dot te bëni asnjë shpenzim te planifikuar.

UJORI

Sido qe te jete puna, ju qe jeni ne një lidhje do dini si ta menaxhoni situatën. Asnjëri prej jush nuk do marre vendime te rritura. Beqaret ne te kundërt do kenë një ditë te mbushur me takime me surpriza. Mire do jete ta shfrytëzojnë sa te mundin. Ne planin financiar po nuk refektuar dhe po nuk mendoat për te ardhmen keni për te pasur probleme.

PESHQIT

Për shkak te ndikimit te madh te Merkurit, jeta juaj ne çift do jete delikate sot. Komunikimi do lere për te dëshiruar dhe kokëfortësia do sjelle debate. Beqaret do takojnë shume persona, por asnjëri nuk do jete ashtu si ata kane ëndërruar. Me e mira do jete te kaloni kohën e lire me miqtë. Ne planin financiar me ne fund gjendja do ketë përmirësim dhe do mund te bëni edhe ndonjë investim.

PËRGJIGJE

Grid for word search puzzle.

SHKRONJA E NJËTË PËR NUMËR TË NJËTË

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

Cryptogram grid with numbers and letters.

# Abonohu!



## [SHQIPTARJA.com]

origjina e lajmit...

Për t'u abonuar ju lutemi kontaktoni me:



### POSTA SHQIPTARE

Tel: 042 375 598 ; 04 237 55 98 ; Cel: 066 20 17 771  
 abonime@postashqiptare.al



### AGJENCIA E ABONIMIT TË SHTYPIT

Tel: 04 422 11 08 ; Cel: 066 20 47 825  
 arben.trenova@yahoo.com



### ADRION LTD

Tel: 04 22 40 018 ; Cel: 069 40 36 824  
 sales@adrionltd.com